



# FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

[www.qpz.gov.al](http://www.qpz.gov.al)

**Nr.94**

**22 korrik**

**2010**

## P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Udhëzim i MF nr.24, datë 16.7.2010	Për procedurat e faljes së tarifës së shërbimit për qarkullimin e automjeteve të huaja .....	5035
Udhëzim i MF nr.25, datë 19.7.2010	Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin nr.26, datë 4.9.2008 “Për taksat kombëtare”, të ndryshuar .....	5035
Vendim i GJK nr.32, datë 21.6.2010	Me objekt shfuqizimin e nenit 68 dhe nenit 71 të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.....	5041
Vendim i GJK nr.33, datë 24.6.2010	Me objekt 1. Shfuqizimin e ligjit nr.10142, datë 15.05.2009 "Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura, të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit Informativ të Shtetit, të Policisë së Burgjeve, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit e të punonjësve të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm në Republikën e Shqipërisë", si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë. 2. Pezullimin e zbatimit të ligjit nr.10142, datë 15.05.2009 "Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura, të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit Informativ të Shtetit, të Policisë së Burgjeve, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit e të punonjësve të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm në Republikën e Shqipërisë" deri në dhënien e vendimit përfundimtar nga Gjykata Kushtetuese.....	5048

**UDHËZIM**  
**Nr.24, datë 16.7.2010**

**PËR PROCEDURAT E FALJES SË TARIFËS SË SHËRBIMIT PËR QARKULLIMIN E  
AUTOMJETEVE TË HUAJA**

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 e Kushtetutës dhe të ligjit nr.9975, datë 28.7.2008 “Për taksat kombëtare”, të ndryshuar, Ministri i Financave

**UDHËZON:**

1.Të gjitha detyrimet e prapambetura të tarifës së shërbimit për qarkullimin e automjeteve të huaja falen në bazë të ligjit nr.9975, datë 28.7.2008 “Për taksat kombëtare”, të ndryshuar.

2.Në pikën e kalimit kufitar në dalje, pronarët e mjeteve me targa të huaja kryejnë veprimet e daljes pa paguar tarifën e shërbimit për qarkullimin e mjeteve të huaja.

3.Për rastet kur automjeti me targë të huaj, me akt noterial, kalon në pronësi të personave të tjerë të cilët më pas do ta pajisin me targë shqiptare sipas legjislacionit në fuqi, pronari i paraqet degës së doganës në momentin e zhdoganimit të automjetit vetëm dokumentet e zhdoganimit të mjetit duke mos pasur detyrimin e pagimit të detyrimeve të akumuluarra për tarifën e shërbimit për qarkullimin e mjeteve të huaja.

4.Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Doganave për sistemin e detyrimeve të prapambetura të subjekteve debitore për tarifën e shërbimit të qarkullimit të mjeteve të huaja.

5.Udhëzimi nr.30, datë 17.10.2008 “Për përcaktimin e tarifës së shërbimit për qarkullimin e automjeteve të huaja”, i ndryshuar, shfuqizohet.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**MINISTRI I FINANCAVE**  
**Ridvan Bode**

**UDHËZIM**  
**Nr.25, datë 19.07. 2010**

**PËR DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR.26, DATË 4.09.2008  
“PËR TAKSAT KOMBËTARE”, TË NDRYSHUAR**

Në zbatim të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në zbatim të ligjit nr.9975, datë 28.07.2008 “Për taksat kombëtare”, të ndryshuar, Ministri i Financave

**UDHËZON:**

Në udhëzimin nr.26, datë 4.09.2008 “Për taksat kombëtare”, të ndryshuar, bëhen shtesat dhe ndryshimet e mëposhtme.

Në pikën 2.2. “Taksa vjetore e qarkullimit rrugor të mjeteve”, paragrafi i parë, i dytë dhe i tretë ndryshohet si më poshtë:

Taksës vjetore të qarkullimit rrugor të mjeteve i nënshtrohen të gjitha mjetet e klasifikuara sipas lidhjes nr.1 të ligjit, që janë të regjistruara në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor. Kjo taksë arkëtohet nga drejtoritë rajonale të shërbimeve të transportit rrugor para kryerjes së kontrollit teknik vjetor.

Pagesa e taksës bëhet në çdo kohë, por gjithnjë para kryerjes së kontrollit teknik vjetor të detyrueshëm të mjetit. Vlera e taksës është vjetore (për vitin kalendarik në të cilin arkëtohet) pavarësisht nga momenti në të cilin ajo paguhet. Mjetet që regjistrohen për herë të parë, në momentin e targimit të tyre, paguajnë vlerën e taksës në raport me kohën e hyrjes në qarkullim në territorin e Shqipërisë. Në

rast se mjete targohe në muajin janar, taksa paguhet e plotë, ndërsa për periudhën në vazhdim në raport me muajt e hyrjes në qarkullim, pavarësisht datës së muajit p.sh.:

Në rast se një mjet targohe në 28 shkurt, vlera e taksës së qarkullimit është e barabartë me vlerën e taksës sipas tipit të mjetit pjesëtuar me 12 dhe shumëzuar me 11, që janë muajt në përdorim.

Pagesa e kësaj takse shoqërohet me faturë, me pullën e taksës, si dhe biletën me numër serial.

Zotëruesi i mjetit e vendos pullën e taksës në xhamin e përparmë të mjetit për të lehtësuar ushtrimin e kontrollit vizual nga organet kompetente. Këto dokumente prodhohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor dhe shpenzimet përballohen nga ky institucion në zbatim të nenit 8 pika 3, shkronja "c" të ligjit. Dokumentet e mësipërme duhet të përmbajnë elemente të sigurisë së lartë, për të shmangur falsifikimin e tyre.

Drejtoria Rajonale të Shërbimeve të transportit rrugor bëjnë regjistrimin ditor të arkëtimit të taksës, që shërbën si dokument bazë për rakordimin e pagesës së taksës me organet e tatimeve. Regjistrimi bëhet në një regjistër të veçantë (ose në mënyrë elektronike), forma dhe përmbajtja e të cilit janë sipas formularit nr.2, bashkëngjitur udhëzimit nr 26, datë 4.9.2008. Këto drejtori, brenda datës 31 janar të çdo viti, dërgojnë në drejtorinë rajonale të tatimeve, listën e mjeteve që nuk kanë paguar taksën për vitin paraardhës, si dhe listën e mjeteve të regjistruara, duke shënuar edhe datën e fundit të kontrollit teknik të mjetit.

Për mjetet që dalin përfundimisht nga qarkullimi, vlera e taksës do të jetë e barabartë në raport me periudhën, që mjeti ka qenë në qarkullim.

Pika 2.3 shfuqizohet.

Pika 2.3.1 ndryshohet me këtë përmbajtje:

2.3.1. Taksa e mjeteve të përdorura të transportit

Taksa e mjeteve të përdorura të transportit llogaritet si më poshtë:

Cilindrata në  $\text{cm}^3$  x koeficienti fiks për çdo vit përdorimi x taksa fikse për llojin e karburantit. Taksa fikse për llojin e karburantit është 25 lekë për naftën dhe 20 lekë për benzinën. Koeficienti për vitet e përdorimit është:

a) për autoveturat (e kreut 8703): 0,5 për çdo vit përdorimi;

b) për mjetet e tjera (të kapitullit 87): 0,25 për çdo vit përdorimi.

"Vit përdorimi" është diferenca ndërmjet vitit, kur mjeti hidhet në qarkullim të lirë në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë me vitin e prodhimit.

Detyrimin për pagimin e taksës e ka importuesi në çastin e importimit dhe shitësi në rastin e shitjes brenda vendit. Drejtoria rajonale të shërbimeve të transportit rrugor llogarisin dhe arkëtojnë detyrimin tatimor përkatës, sipas procedurave të përcaktuara në këtë udhëzim. Pagesa e detyrimit të taksës bëhet nga shitësi para kryerjes së regjistrimit të aktit të kalimit të së drejtës së pronësisë së mjetit në DRSHTRR. Taksa e mjetit në momentin e shitjes paguhet në një nga bankat e vendit për llogari të Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit të Transportit Rrugor ose në sportelet e drejtorive rajonale të shërbimeve të transportit rrugor. Blerësi i mjetit, në momentin e paraqitjes së dokumentacionit për regjistrim të mjetit në pronësi të tij pranë drejtorisë rajonale të shërbimeve të transportit rrugor, duhet që të paraqesë edhe kopje të mandatpagesës së taksës së mjetit në momentin e shitjes, sipas formulave të këtij udhëzimi, e paguar nga shitësi i mjetit. Pa mandatarkëtimin, drejtorinë rajonale të shërbimit të transportit rrugor nuk procedojnë me regjistrimin e mjetit.

DRSHTRR mbledhin taksën e mjetit dhe e derdhin brenda 10 ditëve nga kryerja e veprimeve për llogari të organeve tatimore, pasi ka mbajtur komisioni prej 2% të shumës së arkëtuar. Brenda datës 10 të muajit pasardhës, DRSHTRR dërgojnë në degën përkatëse të tatimeve evidencën përkatëse, e cila përmbledh emrin e shitësit të mjetit, shumën e llogarit të taksës së mjetit të përdorur, si dhe numrin dhe datën e dokumentit të derdhjes së kësaj takse në organin tatimor.

Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor bën regjistrimin ditor të arkëtimit të taksës së mjetit të shitur, që shërbën si dokument bazë për rakordimin e pagesës së taksës me organet tatimeve. Regjistrimi bëhet në një regjistër të veçantë ose në mënyrë elektronike.

A. Mënyra e llogaritjes së taksës së mjetit të përdorur të transportit, në vitin 2010 dhe në vitet në vijim.

Për të gjitha mjetet e përdorura të transportit (të kapitullit 87 të NKM) që importohen pas hyrjes në fuqi të ligjit dhe shitjet që do të pësojnë këto mjete brenda vendit, taksa e mjetit të përdorur të transportit do të llogaritet me formulën e përcaktuar me ligj:

*Në rastin e importimit:* Cilindrata në cm<sup>3</sup> x koeficienti fiks për çdo vit përdorimi x taksa fikse për llojin e karburantit.

*Në rastin e shitjeve brenda vendit:* Taksa për t'u paguar në momentin e shitjes = taksa e mjetit të përdorur të transportit në vitin e shitjes minus taksën e importimit të mjetit të hedhur në qarkullim të lirë në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë.

**Në import:**

*Shembull 1*

**Në import:**

Në rast se një individ importon në gusht 2010 një makinë tip autoveturë, (kreu 8703 i NKM) me cilindrata 1700 cm<sup>3</sup>, që punon me naftë dhe vite përdorimi 4 vjet (e prodhuar në vitin 2006), taksa e mjetit të përdorur në momentin e importimit është:

$$= \text{Cilindrata në cm}^3 \times \text{koeficienti fiks për çdo vit përdorimi} \times \text{taksa fikse për llojin e karburantit} \\ = 1700 \times 25 \times 0.5 \times 4 = 85\,000 \text{ lekë.}$$

**Në shitjet brenda vendit:**

Në rast se ky mjet do të shitet pas 2 vitesh, në vitin 2012, taksa për t'u paguar në momentin e shitjes do të jetë:

Taksa e mjeteve të përdorura të transportit = taksa e mjetit të përdorur të transportit në vitin e shitjes – taksën e importimit të mjetit në momentin e hedhjes në qarkullim (sipas tabelës nr.1 më poshtë)  
 $= 1700 \times 25 \times 0.5 \times 6 \text{ minus } 1700 \times 25 \times 0.5 \times 4 = 127\,500 \text{ lekë} - 85\,000 \text{ lekë} = 42\,500 \text{ lekë.}$

Në rast se individ i do ta shesë makinën në një nga vitet e mëtejshme, 2013 ose 2014, llogaritja e formulës bëhet duke u spostuar në tabelën e mësipërme sipas viteve të përdorimit të mjetit.

Tabela nr. 1

Cilindrata në cm <sup>3</sup>	Taksa fikse	Koeficient	Vitet e përdorimit	Taksa (në lekë)
1,700	25	0.5	1	21,250
1,700	25	0.5	2	42,500
1,700	25	0.5	3	63,750
1,700	25	0.5	4	85,000
1,700	25	0.5	5	106,250
1,700	25	0.5	6	127,500
1,700	25	0.5	7	148,750
1,700	25	0.5	8	170,000
1,700	25	0.5	9	191,250
1,700	25	0.5	10	212,500

*Shembull 2*

Në rast se në vitin 2006 një individ ka importuar një autoveturë të re (kreu 8703 i NKM) me cilindrata 2500 cm<sup>3</sup>, që punon me benzinë, e prodhuar po në atë vit, dhe në nëntor 2010 kjo makinë do të shitet, qytetari do të paguajë taksën e mjetit të përdorur të transportit si më poshtë:

Taksa e mjetit të përdorur të transportit = taksa e mjetit të përdorur të transportit në vitin 2010 – taksën e importimit të mjetit në vitin 2006

$$\text{Taksa e mjetit të përdorur të transportit} = 2500 \times 20 \times 0.5 \times 4 - 0$$

$$\text{Taksa e mjetit të përdorur të transportit} = 100\,000 \text{ lekë}$$

*Shënim. Në vitin 2006, në momentin e importimit individ i nuk ka paguar taksën e importimit të mjetit, sepse është autoveturë e re e prodhuar në 2006 dhe e hedhur në qarkullim të lirë në Shqipëri po në vitin 2006.*

Sipas shembullit 2 do të vepohet edhe në rastet e shitjes së mjeteve të blera me 0 (zero) km brenda vendit nga koncesionarët.

B. Për të gjitha mjetet e përdorura të transportit (të kapitullit 87 të NKM), të cilat janë importuar para hyrjes në fuqi të ligjit nr. 9769, datë 09.07.2007, në rastin e shitjes së mjetit brenda vendit, taksa e mjetit të përdorur për t'u paguar do të llogaritet me formulën e mëposhtme:

Taksa për t'u paguar në momentin e shitjes = taksa e llogaritur e mjetit të përdorur të transportit në vitin e shitjes minus taksën e importimit të mjetit të përdorur, të llogaritur me formulën e ligjit nr. 9769, datë 9.07.2007, pavarësisht nga viti i importimit.

#### *Shembull 3*

Në rast se një individ ka importuar në vitin 2006, një makinë tip autoveturë (kreu 8703 i NKM) me cilindrata 1700 cm<sup>3</sup>, që punon me benzinë dhe vite përdorimi 4 vjet, dhe do ta shesë në gusht 2010, pagimi i taksës së mjetit të përdorur do të jetë si më poshtë:

Taksa e mjetit të përdorur të transportit = taksa e mjetit të përdorur të transportit në vitin e shitjes – taksën e importimit të mjetit të përdorur, llogaritur me formulën e ligjit nr.9769, datë 9.07.2007.

Në vitin e shitjes, autovetura ka 6 vite përdorimi.

Taksa e mjetit të përdorur të transportit në vitin e shitjes =  $1700 \cdot 20 \cdot 0.5 \cdot 6 = 127\ 500$  lekë

Autovetura në momentin e importimit ka pasur 4 vite përdorimi, për këtë arsye, si koeficient për vitet përdorimi merret 0.0024.

Taksën e importimit të mjetit llogaritur me formulën e ligjit nr.9769, datë 9.07.2007 =  $1700 \cdot 20000 \cdot 0.0024 = 81\ 600$  lekë.

Taksa për t'u paguar = 127 500 lekë minus 81 600 lekë

Taksa për t'u paguar = 45 900 lekë

b.1) Në rast se mjete i përdorur do të rishitet brenda vendit, taksa për t'u paguar do të llogaritet me formulën:

Taksa për t'u paguar në momentin e shitjes = taksa e mjetit të përdorur të transportit në vitin e shitjes minus taksa e llogaritur e mjetit të përdorur në vitin e shitjes së mëparshme.

Në vijim të shembullit 3, në rast se ky mjet do të shitet pas 2 vitesh, në vitin 2012, taksa për t'u paguar në momentin e shitjes do të jetë:

Taksa për t'u paguar në vitin e shitjes 2012 do të jetë:  $1700 \cdot 20 \cdot 0.5 \cdot 8 = 170\ 000$  lekë

Taksa e llogaritur në vitin e shitjes së mëparshme (viti 2010) =  $1700 \cdot 20 \cdot 0.5 \cdot 6 = 127\ 500$  lekë

Taksa për t'u paguar në shitje në vitin 2010 = 170 000 lek minus 127 500 lekë = 42 500 lekë

#### *Shembull 4*

Një makinë tip autoveturë (kreu 8703 i NKM) e prodhuar në vitin 1986, me cilindrata 2500 cm<sup>3</sup>, që punon me naftë, është importuar në Shqipëri në vitin 2002. Kjo makinë do të shitet në nëntor 2010. Taksa e mjetit të përdorur për t'u paguar do të jetë:

Taksa e mjetit të përdorur për t'u paguar = taksa e mjetit në momentin e shitjes minus taksa e importimit të mjetit të llogaritur sipas formulës së ligjit nr. 9769, datë 9.07.2007.

Taksa e mjetit të përdorur në momentin e shitjes =  $2500 \cdot 25 \cdot 0.5 \cdot 21 = 656\ 250$  lekë

Taksa e importimit të mjetit llogaritur sipas formulës së ligjit nr. 9769, datë 9.07.2007

=  $2500 \cdot 25000 \cdot 0.0048 = 300\ 000$  lekë

Taksa për t'u paguar = 656 250 lekë minus 300 000 lekë = 356 250 lekë

C. Për të gjitha mjetet e përdorura të transportit (të kapitullit 87 të NKM), të cilat janë importuar pas hyrjes në fuqi të ligjit nr. 9769, datë 9.07.2007, në rastin e shitjes brenda vendit, taksa e mjetit të përdorur për t'u paguar do të llogaritet me formulën e mëposhtme.

Taksa për t'u paguar në momentin e shitjes = taksa e mjetit të përdorur të transportit në vitin e shitjes minus taksën e importimit të mjetit të hedhur në qarkullim të lirë në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë.

#### *Shembull 5*

Në rast se një individ ka importuar në vitin 2008, një makinë tip autoveturë (kreu 8703 i NKM) me cilindrata 1700 cm<sup>3</sup>, që punon me naftë dhe vite përdorimi 4 vjet, dhe do ta shesë në gusht 2010, pagimi i taksës së mjeteve të përdorura do të jetë si më poshtë:

Taksa e mjeteve të përdorura të transportit të mjetit = taksa e mjetit të përdorur të transportit të mjetit në vitin e shitjes – taksën e importimit të mjetit në momentin e hedhjes në qarkullim të lirë.

Në vitin 2010, mjete ka 6 vite përdorimi, kështu që:

Taksa e mjetit të përdorur të transportit në vitin 2010 =  $1700 \cdot 25 \cdot 0.5 \cdot 6 = 127\ 500$  lekë (sipas tabelës nr. 1 më lart)

Në vitin 2008, në momentin e importimit autovetura ka 4 vite përdorimi.

Taksa e importimit të mjetit në vitin 2008 =  $1700 \cdot 25000 \cdot 0.0024 = 102\,000$  lekë (llogaritur me formulën e ligjit nr. 9975, datë 28.7.2008 “Për taksat kombëtare”).

Taksa e mjetit të përdorur të transportit në momentin e shitjes =  $127\,500$  lekë –  $102\,000$  lekë =  $25\,500$  lekë.

D. Në rastet kur një mjet i përjashtuar nga detyrimet doganore në import shitet pas hedhjes në qarkullim të lirë, taksa e mjeteve të përdorura të transportit në momentin e shitjes do të paguhet sipas formulave të përdorura për mjetet të cilat janë importuar para dhe pas datës 5.08.2007, pra, para dhe pas hyrjes në fuqi të ligjit nr 9769, datë 9.07.2007.

E. Në rastet kur mjetet (e kapitullit 87 të NKM) e hedhura në qarkullim të lirë, kanë pësuar modifikime të cilat ndikojnë në klasifikimin tarifor të tyre sipas NKM, pas shitjes do të paguhet taksa e mjetit të përdorur të transportit në proporcion me vitet e përdorimit sipas secilit destinacion (në përputhje me klasifikimin).

Ë. Në rastet e shitjes së mjeteve (të kapitullit 87 të NKM) nga shoqëritë e leasing financiar të qiramarrësi, ky transaksion konsiderohet si shitje e parë dhe nuk është subjekt i taksës së mjetit të përdorur të transportit në momentin e shitjes. Në rastin e shitjes së dytë e të mëvonshme, llogaritet taksa e shitjes sipas përcaktimeve të këtij ligji.

F. Rastet e transaksioneve të traktorëve bujqësorë dhe të motokultivatorëve të cilat nuk kanë si funksion parësor “transportin” nuk janë subjekt i taksës së mjeteve të përdorura të transportit.

G. Në rastet kur pronarët e mjetet e përdorura të transportit (të kapitullit 87 të NKM) kanë bërë kalimin e pronësisë së mjetit me kontrata noteriale para hyrjes në fuqi të ligjit nr. 10 280, datë 20.5.2010 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9975, datë 28.7.2008 “Për taksat kombëtare”, të ndryshuar, nuk janë subjekt i taksës së mjetit të përdorur të transportit .

GJ. Rastet e shitjes së mjeteve të përdorura të transportit nga persona juridikë publikë, sipas përkufizimit të dhënë në nenin 25 të Kodit Civil, nuk janë subjekt i dispozitave të këtij udhëzimi.

Pika 2.3.2 ndryshohet si më poshtë:

“2.3.2. Taksa e karbonit për benzinën, benzolin dhe gazoilin

Taksa e karbonit caktohet në masën 1,5 lekë për litër për benzinën (sipas kodeve tarifore të NKM-së 2710 11 41, 2710 11 45, 2710 11 49, 2710 11 51, 2710 11 59), 3 lekë për litër për gazoilin (sipas kodeve tarifore 2710 19 31, 2710 19 35, 2710 19 41, 2710 19 45, 2710 19 49) dhe 3 lekë për kilogram për qymyrin, me krahë tariforë të NKM-së 2701 dhe 2702.”.

Kjo taksë zbatohet si për karburantet dhe qymyrin e importuar, ashtu edhe për ato të prodhuara në vend.

Kjo taksë paguhet në momentin e deklarimit në doganë të benzinës apo gazoilit të importuar.

Taksa e karbonit për benzinën dhe për gazoilin e importuar nuk përfshihet në bazën e taksueshme për efekt të llogaritjes së taksës doganore, TVSH-së dhe akcizës.

Taksat e karbonit për benzinën dhe gazoilin e importuar, për mallrat që vendosen në regjimin e pezullimit tatimor ose doganor, nuk aplikohet në momentin e vendosjes në këto regjime, por në momentin kur mallrat çlirohen nga këto regjime.

Për gazoilin dhe benzinën e prodhuar në vend, prodhuesit deklarojnë dhe paguajnë taksën e karbonit në degën përkatëse të tatimeve në momentin e lëvizjes së këtyre produkteve nga vendi i prodhimit.

Shumat e arkëtuara nga kjo taksë derdhen çdo 5 ditë në llogarinë e degës përkatëse të tatimeve.”.

Pika 2.3.3 shfuqizohet.

Pika 2.4 ndryshohet me këtë përmbajtje:

“2.4. Taksa e rentës minerare

Taksa e rentës minerare përcaktohet në pikën 4 të ligjit nr. 9975, datë 28.07.2008 “Për taksat kombëtare”, të ndryshuar. Këshilli i Ministrave përcakton procedurat e arkëtimit së rentës minerare dhe dokumentacionin që duhet të paraqesë i licencuari, eksportuesi, për të vërtetuar çmimin e shitjes.”.

Pika 2.6 shfuqizohet.

Pika 1 dhe 2 e pikës 3 “Përjashtime nga taksat kombëtare” ndryshohet me këtë përmbajtje:

“3. Përjashtime nga taksat kombëtare

1. Përjashtohen nga pagimi i taksës vjetore të qarkullimit rrugor të mjeteve:

a) mjetet në pronësi të ambasadave dhe organizatave ndërkombëtare, që gëzojnë statusin diplomatik, të akredituara në Republikën e Shqipërisë, duke zbatuar parimin e reciprocitetit;

“b) personat fizikë ose juridikë, të cilët deklarojnë, brenda muajit janar të vitit në vazhdim, se nuk do të qarkullojnë me mjetet në pronësi të tyre gjatë këtij viti kalendarik, ose do të dalin përfundimisht nga qarkullimi dhe dorëzojnë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor targën dhe lejen e qarkullimit të mjetit;

b.1) pagesat e taksës së mjeteve të bllokuara me vendim të gjykatës, prokurorisë etj., për periudhën në të cilën mjete ka qenë i bllokuar. Lidhur me këtë përjashtim, pronari i mjetit duhet të paraqesë pranë drejtorive rajonale të shërbimit të transportit kopje të vendimit të gjykatës ose të prokurorisë. Në rast se mjete zhblokohet në muajin janar, taksa paguhet e plotë, ndërsa për periudhën në vazhdim në raport me muajt e mbetur të vitit që do të qarkullojë (ashtu si ato që regjistrohen për herë të parë në Shqipëri, sipas pikës 2.2).

c) Invalidët dhe veteranët e luftës kundër pushtuesve nazifashistë të popullit shqiptar, invalidët e punës, të verbërit, invalidët paraplegjikë dhe tetraplegjikë që e fitojnë këtë status në bazë të ligjeve përkatëse, kur mjete është në zotërimin e tyre, dhe përdoret vetëm për nevojat e tyre personale dhe jo për aktivitet privat. Sipas nenit 16/1 të ligjit nr. 7889, datë 14.12.1994 “Për statusin e invalidit”, si dhe të nenit 4 të ligjit nr. 8098, datë 28.03.1996 “Për statusin e të verbërit”, kur invalidi i punës dhe personi i verbër ushtron veprimtari private, nuk përjashtohet nga pagimi i kësaj takse.

2. Përjashtohen nga pagimi i taksës së mjeteve të përdorura të transportit, në import dhe në shitje, autoveturat tip 4+1 vende dhe me cilindrata jo më shumë se 2500 kubikë, kur këto mjete kalojnë në zotërim të invalidëve e të veteranëve të luftës kundër pushtuesve nazifashistë të popullit shqiptar, invalidëve të punës, të verbërve, invalidëve paraplegjikë dhe tetraplegjikë që e fitojnë këtë status në bazë të ligjeve përkatëse dhe përdoren vetëm për nevojat e tyre personale dhe jo për veprimtari private. Kjo kategori përfiton përjashtimin e kësaj takse sa here tjetërsojnë një mjet, si në import edhe në shitje.

*Për shembull:* Nëse një invalid importon një mjet për nevoja personale në këtë rast ai bëhet pronar i mjetit dhe përjashtohet nga taksa e mjetit në momentin e importimit. Edhe nëse invalidi e shet këtë mjet pas dy vitesh, ai përjashtohet nga taksa e mjetit të përdorur në momentin e shitjes.

Përjashtimi nga pagimi i taksave të mësipërme bëhet vetëm kur veprimet bëhen në emër të veteranit të luftës, invalidit të punës a të luftës, të verbërit, të sëmurëve paraplegjikë dhe tetraplegjikë.

Veterani i luftës, invalidi i luftës apo i punës, personat e verbër, si dhe të sëmurët paraplegjikë dhe tetraplegjikë duhet të paraqesin pranë agjentit tatimor, librezën përkatëse së bashku me dokumentin e identifikimit të personit që përfiton përjashtimin nga taksa.”.

Pas pikës 4, shtohet pika 4.1 me këtë përmbajtje:

“4.1. Personat që gëzojnë statusin e invalidit, në bazë të ligjit nr.7889, datë 14.12.1994 “Për statusin e invalidit”, të ndryshuar, statusin e invalidit të luftës, në bazë të ligjit nr. 7663, datë 20.1.1993 “Për statusin e invalidit të luftës kundër pushtuesve nazifashistë të popullit shqiptar”, statusin e veteranit të luftës, në bazë të ligjit nr.7874, datë 17.11.1994 “Për statusin e veteranit të luftës kundër pushtuesve nazifashistë të popullit shqiptar”, të ndryshuar, apo statusin e të verbërit, në bazë të ligjit nr. 8098, datë 28.3.1996 “Për statusin e të verbërit”, përjashtohen nga:

a) tarifa për shërbimet konsullore e Ministrisë së Punëve të Jashtme apo e ambasadave tona jashtë vendit;

b) tarifa për përdorimin e aparateve televizive e Radiotelevizionit Publik;

c) tarifa për pajisjen me pasaportë lundrimi e Kapitenerisë së Porteve;

ç) tarifa e pajisjes me leje drejtimi e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor.

2. Personat e sipërpërmendur nuk i përfitojnë këto përjashtime nëse kryejnë veprimtari private si persona fizikë apo juridikë.”.

Ky udhëzim hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I FINANCAVE  
**Ridvan Bode**

**VENDIM**  
**Nr.32, datë 21.6.2010**

**NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Vladimir Kristo	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Fehmi Abdiu	Anëtar i “ “
Kujtim Puto	Anëtar i “ “
Xhezair Zaganjori	Anëtar i “ “
Petrit Ploçi	Anëtar i “ “
Vitore Tusha	Anëtare e “ “
Sokol Berberi	Anëtar i “ “
Admir Thanza	Anëtar i “ “
Sokol Sadushi	Anëtar i “ “

me sekretare Blerina Çinari, në datën 15.12.2009 mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.31/19 Akti, që i përket:

**KËRKUES:** PARTIA BASHKIMI POPULLOR I PENSIONISTËVE SHQIPTARË (PBPSH), e përfaqësuar nga kryetari Selami Jenishehri.

**SUBJEKTE TË INTERESUARA:**

**KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**, përfaqësuar nga Lulzim Lelçaj, me autorizim.

**KËSHILLI I MINISTRAVE**, përfaqësuar nga Marsida Xhaferllari, me autorizim.

**OBJEKTI:** Shfuqizimi si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë i nenit 68 dhe nenit 71 të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”.

**BAZA LIGJORE:** Neni 1/3, 3, 131/a dhe 134/1/f të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; nenet 49, 50 dhe 51 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

**GJYKATA KUSHTETUESE,**

pasi dëgjoji relatorin e çështjes Sokol Sadushi, përfaqësuesin e kërkuarit që kërkoji pranimin e kërkesës, përfaqësuesit e subjekteve të interesuara që kërkuan rrëzimin e kërkesës dhe shqyrtoi çështjen në tërësi,

**VËREN:**

**I**

1. Kuvendi i Republikës së Shqipërisë (Kuvendi), me ligjin nr.10019, datë 29.12.2008, ka miratuar Kodin Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë. Neni 68 i Kodit Zgjedhor parashikon: “Listat e kandidatëve për Kuvendin, të paraqitura nga partitë politike, të cilat nuk zotërojnë asnjë mandat në Kuvend, duhet të mbështeten nga jo më pak se 10000 zgjedhës. Në rastin e koalicionit zgjedhor listat duhet të kenë marrë mbështetjen e jo më pak se 15000 zgjedhësve. Bën përjashtim nga ky rregull koalicioni ku partitë pjesëtare zotërojnë bashkërisht në Kuvend një numër mandatesh jo më të vogël se numri i partive pjesëtare të koalicionit.” Në nenin 71 parashikohet: “1. Zgjedhësit depozitojnë në mënyrë individuale nënshkrimet e tyre për mbështetjen e kandidatit të propozuar nga një grup zgjedhësish apo për partitë dhe koalicionet e parashikuara në nenet 68 dhe 69 të këtij Kodi në KQZ apo përpara noterit. Për zgjedhjet e organeve të qeverisjes vendore, sipas nenit 70 të Kodit, nënshkrimet depozitohen përpara nëpunësit të KZAZ-së ose noterit. 2. Nënshkrimi shoqërohet me të dhënat e plota të zgjedhësit, ku përfshihet emri dhe mbiemri, vendbanimi i përhershëm dhe numri i dokumentit të identifikimit. Zgjedhësi duhet të jetë i regjistruar në zonën zgjedhore përkatëse dhe nuk mund të mbështesë më shumë se një kandidat, parti apo koalicion. 3. KQZ-ja miraton dhe vë në dispozicion formularin për depozitimin individual të nënshkrimit jo më vonë 90 ditë para datës së zgjedhjeve.”

2. Partia Bashkimi Popullor i Pensionistëve Shqiptarë (PBPSH) është një person juridik i regjistruar sipas ligjit nr.8580, datë 17.2.2000 “Për partitë politike” me vendimin nr.3378, datë



24.04.2009 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor të Tiranës. Sipas kërkesës së paraqitur në Gjykatën Kushtetuese, ky subjekt politik ka deklaruar se ka pasur vullnetin të marrë pjesë aktivisht në zgjedhjet politike të zhvilluara më 28.06.2009, por nuk ka mundur të regjistrohet si subjekt pjesëmarrës në zgjedhje në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, pasi (sipas tij) ka qenë praktikisht “i pakapërcyeshëm” sigurimi i 10 000 nënshkrimeve të mbështetësve të tij, procedurë e cila në bazë të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” duhet të kryhet në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) apo përpara noterit.

**3. Kërkuesi**, përmes përfaqësuesit të tij, i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese dhe ka kërkuar shfuqizimin si antikushtetues të dispozitave të sipërcituara të Kodit Zgjedhor, duke pretenduar se:

3.1 Është cenuar e drejta kushtetuese e barazisë përpara ligjit, parashikuar nga neni 18 i Kushtetutës. Pretendimi i mësipërm, i paraqitur fillimisht në kërkesë, është përpunuar gjatë seancës plenare, se e drejta kushtetuese e cenuar ishte ajo e “barazisë në zgjedhje”, e sanksionuar nga neni 1, pika 3 e Kushtetutës.

3.2 Sipas kërkuesit, rregullimi i parashikuar nga nenet 68 dhe 71 të Kodit Zgjedhor krijon një barrierë të pakapërcyeshme për subjektet e reja politike që dëshirojnë të marrin pjesë në zgjedhje, pasi ajo e kushtëzon pjesëmarrjen e tyre në garën zgjedhore me mbështetjen e 10.000 personave që duhet të nënshkruajnë përpara noterit ose pranë KQZ-së. Sipas përlllogaritjeve të kërkuesit, rezulton se për të marrë nënshkrimet e 10 000 zgjedhësve përpara noterit duhen të paktën 15 milionë lekë të reja, vetëm për pagesën të noterit. Gjithashtu, edhe në lidhje me depozitimin e kërkesave në KQZ, duhet që 10 000 zgjedhës të vijnë nga dhjetra kilometra larg për të nënshkruar listën përkatëse. Duke qenë se një pjesë e mirë e zgjedhësve potencialë të kësaj partie gjendet me banim në zonat rurale të vendit, ardhja e tyre për të nënshkruar pranë noterit në qytet ose përpara KQZ-së në Tiranë është një shpenzim i konsiderueshëm dhe i papërbalueshëm, po të merret parasysh edhe se shtresa e pensionistëve është një ndër shtresat më në nevojë aktualisht.

3.3 Duke vendosur një parakusht të tillë, ligjvënësi ka bërë një diskriminim ndërmjet partive që përfaqësohen me deputetë në Kuvend (të cilëve nuk iu kërkohet plotësimi i këtyre kushteve) dhe atyre që nuk përfaqësohen. Në diferencimin ndërmjet subjekteve politike ndikon edhe fakti që partitë parlamentare, pikërisht për shkak të përfaqësimit në Kuvend, ndihmohen edhe financiarisht me fonde publike nga shteti me rastin e nisjes së fushatës zgjedhore.

3.4 Rregullim ligjor ka efekte kufizuese për pluralizmin politik në vend, pasi konsolidon pushtetin e një grupi partish aktuale, ndërsa vështirëson zhvillimin e subjekteve të reja politike.

**4. Përfaqësuesi i subjektit të interesuar, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë**, ka kërkuar rrëzimin e kërkesës, duke pretenduar se:

4.1 Pamundësia për të marrë pjesë në zgjedhje për kërkuesin nuk ka ardhur për sa ai pretendon, por për shkak se është regjistruar si parti politike në datë 24.04.2009. Për këtë arsye, ky subjekt politik nuk është regjistruar brenda afatit 60- ditor të parashikuar nga neni 64 i Kodit Zgjedhor. Rrjedhimisht, në mungesë të shkakut të pretenduar, kërkuesi nuk legjitimohet të ngrejë kërkesë si subjekt i parashikuar nga shkronja “f” e nenit 134, pika 1 e Kushtetutës.

4.2 Detyrimi për mbledhjen e një numri të caktuar nënshkrimesh për të paraqitur kandidaturën është sanksionuar në frymën e udhëzimeve të Raportit Shpjegues të Kodit të Praktikës së Mirë në Çështjet Zgjedhore të Komisionit të Venecias, sipas të cilit ky detyrim është në pajtueshmëri me parimin e votimit të përgjithshëm dhe, si rrjedhojë, edhe me parimin e sovranitetit popullor, i cili buron nga parimi i zgjedhjeve të përgjithshme. Sipas këtyre udhëzimeve, mbështetja nga nënshkrimet e mbledhura duhet të zbatohet në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe të barabartë për të gjitha subjektet dhe përjashtimet duhet të jenë të bazuara në suksesin e mëparshëm zgjedhor, qoftë dhe me një mandat të fituar.

4.3 Pretendimi se nënshkrimi në KQZ ose përpara noterit përbën një kufizim është i gabuar, pasi kryerja e nënshkrimit në një nga format e mësipërme është një detyrim ligjor, përmbushja e të cilit zhdok mundësinë e manipulimit dhe të falsifikimit të dokumentacionit, për të mos cenuar standardet për zgjedhje të ndershme.

4.4 Detyrimi ligjor për depozitimin e nënshkrimit individualisht përpara një noterit ose në KQZ vendoset në ligjin zgjedhor në kushtet e procesit të integritetit në Bashkimin Europian, si një domosdoshmëri për përmbushjen e detyrimit për dokumentacion të rregullt me çdo kusht dhe pa asnjë pretendim, aq më tepër kur gjithçka bëhet në pajtueshmëri dhe në zbatim të ligjeve.

5. **Përfaqësuesi i subjektit të interesuar, Këshilli i Ministrave**, ka kërkuar rrëzimin e kërkesës, duke pretenduar se:

5.1 Kërkuuesi nuk legjitimohet për të iniciuar këtë gjykim kushtetues, pasi partitë janë subjekte që në respekt të nenit 134, pika 1, shkronja “f” të Kushtetutës kanë legjitimitet të kufizuar, vetëm në lidhje me çështje që lidhen me interesat e tyre. Një gjë e tillë nuk rezulton e provuar për këtë subjekt politik.

5.2 Kodi Zgjedhor parashikon se depozitimi në mënyrë individuale i nënshkrimit mund të bëhet edhe përpara KQZ-së, procedurë kjo që nuk ka kosto financiare. Gjithashtu, deklarata noteriale përpara noterit mund të bëhet në mënyrë të grupuar nga ana e zgjedhësve, çka do t'i reduktonte shpenzimet noteriale vetëm në vlerën e një akti të vetëm.

5.3 Pretendimi për shkelje të barazisë përpara ligjit (neni 18/1 i Kushtetutës) është i pabazuar. Në nenin 71 të Kodit Zgjedhor nuk ka diskriminim për arsye ekonomike pasi procedura e nënshkrimit nuk ka kosto financiare. Kriteri i pjesëmarrjes në Kuvend, i pretenduar nga kërkuuesi, nuk përbën shkak për diskriminim të padrejtë, sepse lidhet me aftësitë dhe meritat e një partie politike. Parimi i mosdiskriminimit nuk mund të nënkuptojë barazi absolute trajtimi, sepse ligji zgjidh në mënyrë të ndryshme situata të ndryshme.

5.4 Parashikimi ligjor për mbështetjen e listës së kandidatëve nga 10 000 zgjedhës është rrjedhojë e ndryshimit të sistemit zgjedhor.

## II

### A. Pretendimi në lidhje me legjitimitimin e kërkuarit

6. Gjykata Kushtetuese (Gjykata) vlerëson që, përpara se të ndalet dhe të analizojë pretendimet e kërkuarit në lidhje me thelbin e çështjes, duhet t'i japë përgjigje pretendimit të përfaqësuesve të subjekteve të interesuara për legjitimitimin e kërkuarit.

7. Gjykata vlerëson se kërkuuesi legjitimohet *ratione personae*. Ai është person juridik i regjistruar si parti politike në bazë të ligjit. Sipas nenit 134/f të Kushtetutës, “partitë politike” janë subjekte që mund të vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese për çështje që lidhen me interesat e tyre. Në këtë rast bëhet fjalë për pjesëmarrjen e kërkuarit në zgjedhjet e përgjithshme, çka është plotësisht në misionin, qëllimin dhe interesin kryesor të një partie politike, pasi vetëm përmes pjesëmarrjes në procesin zgjedhor një parti mund të marrë mbështetjen formale nga zgjedhësit dhe të mundësojë pjesëmarrjen e kandidatëve të saj në Kuvend. Në këtë mënyrë ajo mund të realizojë që programi i saj politik të jetë një program qeverisës.

8. Kërkuuesi legjitimohet *ratione temporis*, pasi kërkesa është paraqitur këtu brenda afatit të parashikuar nga ligji organik i kësaj Gjykate nr.8577, datë 10.02.2000.

9. Përsa i përket legjitimitimit *ratione materiae*, Gjykata vlerëson se është rasti të ritheksojë qëndrimin e saj se në gjykime të kontrollit të kushtetutshmërisë së normës, subjektet që parashikohen në nenin 134, pika 2 të Kushtetutës kanë detyrimin për të provuar lidhjen e domosdoshme që duhet të ekzistojë ndërmjet funksionit e veprimtarisë ligjore që ato kryejnë dhe çështjes kushtetuese të ngritur. Partitë politike janë të specifikuar në nenin 134, pika 1, shkronja “f” të Kushtetutës si një ndër subjektet që e ushtrojnë në mënyrë të kushtëzuar të drejtën për t'iu drejtuar Gjykatës Kushtetuese. Ato kanë legjitimitet kushtetues vetëm për ato çështje që lidhen me interesat e tyre. Në kuptimin kushtetues dhe ligjor, partitë politike paraqiten si bashkime vullnetare të shtetasve mbi bazën e ideve, të bindjeve e të pikëpamjeve politike të përbashkëta, që synojnë të ndikojnë në jetën e vendit nëpërmjet pjesëmarrjes në zgjedhje dhe përfaqësimit të popullit në organet e zgjedhura të pushtetit. Partitë politike në sistemin e zgjedhjeve e veçanërisht në procesin zgjedhor, që nga fushata parazgjedhore, paraqitja e kandidatëve, formimi i trupave zgjedhore, ndjekja e zgjedhjeve e deri te ndarja e mandateve, paraqiten si një faktor përcaktues shumë i rëndësishëm. Prandaj, demokracia përfaqësuese, ashtu edhe sistemi i zgjedhjeve nuk mund të paramendohen pa ekzistencën dhe funksionimin e partive politike. Ky pozicion i veçantë që partitë politike kanë në raport me zgjedhjet, përcakton njëkohësisht dhe interesin e tyre për të pasur një legjislacion dhe rregulla sa më të qartë e të drejtë (*Shih vendimin nr.1, datë 7.01.2005 të Gjykatës Kushtetuese*). Mbi bazën e këtij arsyetimi, Gjykata vlerëson legjitimitimin e kërkuarit në rastin në shqyrtim.

## B. Në lidhje me pretendimet e kërkuessit

10. Kërkuessi pretendon se nenet 68 dhe 71 të Kodit Zgjedhor cenojnë të drejtën e tij kushtetuese për zgjedhje të barabarta, të sanksionuara nga neni 1, pika 3 e Kushtetutës dhe *parimin e pluralizmit*, si një nga bazat e shtetit, sanksionuar nga neni 3 i Kushtetutës. Në rastin në shqyrtim, duke qenë se, sipas kërkuessit rregullimi ligjor në fjalë ka efekte kufizuese për pluralizmin politik në vend, pasi konsolidon pushtetin e një grupi të caktuar partish aktuale dhe vështirëson zhvillimin e subjekteve të reja politike, Gjykata vlerëson se pretendimet e kërkuessit duhet të analizohen të pashkëputura nga njëri-tjetri.

11. Gjykata thekson se pluralizmi është një tërësi rrethanash ku pushteti politik është i shpërndarë në atë mënyrë që asnjë grup interesi ose klasë e caktuar shoqërore të mos mbizotërojë mbi të tjerët. Kushti bazë për pluralizmin janë zgjedhjet e lira, shumësia e interesave, lejimi i hapësirave për organizimin e mekanizmave të presionit ndaj organeve të pushtetit dhe një shtet që është i përgjegjshëm ndaj nevojave të qytetarëve. Në çdo sistem demokratik, përfaqësuesit e popullit në qeverisje zgjidhen përmes zgjedhjeve shumëpartiake, *të lira, të barabarta dhe të ndershme*. Pushteti i përfaqësuesve kufizohet nga kushtetuta dhe mekanizma të tjerë të balancimit dhe kontrollit të pushteteve. Problemet e përfaqësimit të drejtë janë çështje të shanseve të barabarta që zëri i gjithkujt të dëgjohet apo të jetë i përfaqësuar. Sidoqoftë, është e lejueshme që një shtet demokratik, nëse ekzistojnë arsye serioze, të vendosë në mekanizmat e procesit zgjedhor disa elemente nxitëse të integritit shoqëror. Nga ana tjetër, një sistem zgjedhor proporcional i pakufizuar mund të rezultojë në ndarjen e votave të qytetarëve ndërmjet një numri shumë të madh partish politike dhe, për pasojë, në një kërcënim për funksionimin dhe vazhdimësinë e sistemit parlamentar, në kuptim të kapaciteteve për të arritur në një vendimmarrje brenda tij. (Shih më gjerë vendimin e Gjykatës Kushtetuese Çeke (CZE-2005-1-001 – referuar nga baza e të dhënave *Codices* të Komisionit të Venecias.)

12. Neni 3 i Kushtetutës parashikon *pluralizmin* si një nga bazat e shtetit, ndërsa neni 1, paragrafi 3 i saj sanksionon *parimin e barazisë së votës*. Ky parim ka komponentin e tij *aktiv* (e drejta për të votuar) dhe atë pasiv (e drejta për t'u votuar/zgjedhur). Gjykata thekson se parimi i barazisë të së drejtës për t'u votuar/zgjedhur ndalon shtetin të diskriminojë ose të privilegjojë kandidatë të caktuar, parti politike ose grupe të tjera politike në përballjen konkurruese për të tërhequr votën e zgjedhësit. Sipas udhëzimeve të Raportit Shpjegues të Kodit të Praktikës së Mirë në Çështjet Zgjedhore të Komisionit të Venecias barazia në çështjet zgjedhore përfshin shumë aspekte. (Shih më gjerë Dokumentin CDL-AD (2002) 23 rev., miratuar nga Komisioni i Venecias në mbledhjen e tij të 52-të Plenare (Venecia, 18-19 Tetor 2002.) Parimet që duhen respektuar në të gjitha rastet janë *barazia në votën numerike, barazia për sa i përket fuqisë zgjedhore dhe mundësive të barabarta*.

13. Duke iu referuar këtyre standardeve të gjithëpranuara, Gjykata çmon se *barazia në të drejtat për votim* kërkon që çdo votues të ketë normalisht të drejtën e një vote dhe të votojë vetëm një herë. *Barazia në fuqinë për votim*, në rastin kur zgjedhjet nuk zhvillohen vetëm në një zonë të vetme zgjedhore, kërkon që kufijtë midis zonave zgjedhore të hartohen në një mënyrë të tillë që mandatet në *dhomën më të ulët*, që përfaqëson popullin, të shpërndahen në mënyrë të barabartë midis zonave zgjedhore, në përputhje me kriterin e veçantë të proporcionalitetit, p.sh. numri i banorëve në zonën zgjedhore, numri i banorëve vendas (duke përfshirë minorenët), numri i zgjedhësve të regjistruar ose mundësisht numri i njerëzve që kanë votuar faktikisht. Mund të jetë i mundur edhe një kombinacion i përshtatshëm i këtyre kritereve. Të njëjtat rregulla zbatohen edhe për zgjedhjet rajonale dhe vendore.

14. Gjykata vlerëson se midis partive dhe kandidatëve duhet të krijohen shanse të barabarta dhe shteti duhet të jetë i paanshëm ndaj tyre, duke zbatuar ligjet në mënyrë të njëjtë për të gjithë. Në veçanti, kërkesa për asnjansësi zbatohet për fushatën zgjedhore dhe mbulimin nga media, veçanërisht media publike, si dhe për financimin publik të partive dhe fushatave, e cila mund të realizohet si në formën e një barazie “strikte”, ashtu dhe të barazisë “proporcionale”. Sipas barazisë “strikte”, partitë politike trajtohen pa marrë në konsideratë forcën e tyre aktuale në Kuvend ose të zgjedhësve, ndërsa sipas barazisë “proporcionale”, trajtimi i partive bëhet në raport me numrin e votave. Parimi i shanseve të barabarta (strikte dhe/ose proporcionale) zbatohet në veçanti për mbulimin në radio dhe televizion, fondet publike dhe forma të tjera mbështetjeje. Disa forma mbështetjeje mund t'u nënshtrohen, nga një anë, barazisë strikte dhe, nga ana tjetër, barazisë proporcionale.

15. Në koncept, parimi i konkurrimit të lirë të partive politike përfshin detyrimin e shtetit për të respektuar shanset e barabarta të të gjitha partive dhe zbatohet në legjisllacionin që rregullon kushtet e këtij konkurrimi, si dhe në konfliktet ndërmjet pjesëmarrësve në të. Duke qenë se një efekt i tillë ndikon

në respektimin e parimit të barazisë, Gjykata vlerëson se çfarëdoj ndërrhyrje nga ligjvënësi mbi këto kushte duhet të udhëhiqet nga interesi publik. Ligjvënësi e ka të ndaluar të trajtojë palët në mënyrë të dallueshme nga njëra-tjetra, përveçse kur ekzistojnë arsye të forta përjashtimore për ta bërë këtë.

16. Neni 68 i ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” parashikon që *listat e kandidatëve për Kuvendin, të paraqitura nga partitë politike, të cilat nuk zotërojnë asnjë mandat në Kuvend, duhet të mbështeten nga jo më pak se 10 000 zgjedhës* (bën përjashtim nga ky rregull koalicioni, ku partitë pjesëtare zotërojnë bashkërisht në Kuvend një numër mandatesh jo më të vogël se numri i partive pjesëtare të koalicionit). Sipas rregullimit të prezantuar nga Kodi Zgjedhor, përveç rritjes së numrit të nënshkruesve nga 7000 zgjedhës, që parashikonte Kodi Zgjedhor pararendës në 10 000 të tillë, është ndryshuar edhe procedura e mbledhjes së nënshkrimeve, e cila më parë, realizohej nga vetë partitë candidate, përmes anëtarëve ose simpatizantëve të tyre. Aktualisht, sipas nenit 71 të ligjit të ankimuar, *zgjedhësit depozitojnë në mënyrë individuale nënshkrimet e tyre për mbështetjen e kandidatit të propozuar nga një grup zgjedhësish apo për partitë dhe koalicionet në KQZ apo përpara noterit.*

17. Nga përfaqësuesit e subjektit të interesuar, Kuvendit, në parashtrimet dërguar Gjykatës, ndërsa nuk argumentohet në vetvete në mënyrë të detajuar arsyeja e rritjes së numrit të nënshkruesve nga njëri Kod Zgjedhor në tjetrin, mbahet qëndrimi se “detyrimi për mbledhjen e një numri të caktuar firmash për të paraqitur kandidaturën është sanksionuar në frymën e udhëzimeve dhe Raportit Shpjegues të Kodit të Praktikës së Mirë në Çështjet Zgjedhore të Komisionit të Venecias, sipas të cilit ky detyrim është në pajtim me parimin e votimit të përgjithshëm dhe, si rrjedhojë, edhe me parimin e sovranitetit popullor nga i cili buron parimi i zgjedhjeve të përgjithshme. Sipas këtyre udhëzimeve, mbështetja nga nënshkrimet e mbledhura duhet të zbatohet në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe të barabartë për të gjitha subjektet dhe përjashtimet duhet të jenë të bazuara në suksesin e mëparshëm zgjedhor, qoftë dhe me një mandat të fituar.”

18. Duke iu referuar Kodit të Praktikës së Mirë në Çështjet Zgjedhore (Udhëzime dhe Raporti Shpjegues) rezultojnë të parashikuar formulimi: “8. Detyrimi për të mbledhur një numër të caktuar *firmash* për të paraqitur kandidaturën është teorikisht në përputhje me parimin e votimit universal. Në praktikë, vetëm partitë shumë të vogla duket se kanë vështirësi për të mbledhur numrin e caktuar të nënshkrimeve. Ky detyrim nuk duhet të pengojë kandidatët të vendosin kandidaturat e tyre. Me qëllim që të parandalohet një manipulim i tillë, është e preferueshme që ligji të caktojë një kërkesë maksimale firmash prej 1%. Procedura e verifikimit të nënshkrimeve duhet të bëhet mbi bazën e rregullave të qarta, veçanërisht përsa i përket afateve kohore, dhe duhet zbatuar për të gjitha nënshkrimet dhe jo vetëm për një kampion të tyre; megjithatë, kur nga verifikimi është vërejtur, përtej çdo dyshimi, se numri i kërkuar i nënshkrimeve është arritur, nuk është e nevojshme të verifikohen nënshkrimet e tjera.” (Shih më gjerë në *CDL-INF (2000) 17,f. 4-5; CDL (99) 67,f 7-8.*)

19. Në analizën e këtyre dokumenteve dhe të Kodit Zgjedhor (2008) (Shih matricat që pasqyrojnë numrin e zgjedhësve në zonat e administrimit zgjedhor bashkëngjitur këtij Kodi, si dhe nga dokumentacioni statistikor i shfaqur në faqen zyrtare në internet të KQZ-së), Gjykatës i rezultojnë se shifrës së sipërcituar prej 1% i korrespondon një numër që varion nga zona në zonë, si p.sh., në qarkun e Tiranës do të ishte përafërsisht 7000 zgjedhës/nënshkrues.

20. Nga një vështrim krahasues i legjislacioneve të vendeve të tjera, Gjykatës i rezultojnë se, sipas Ligjit Zgjedhor Federal të RF Gjermane (*Bundewahlgesetz*), (neni 27) “në rastin e partive politike të përmendura në nenin 18/2, ato duhet të jenë nënshkruar nga 1/1000 të personave me të drejtë vote në Land në zgjedhjet e fundit të Bundestag-ut, por jo më shumë se 2000 persona me të drejtë vote.” Pra, në rastin gjerman, minimumi i nënshkrimeve është 0.1% (1/1000,) ndërsa maksimumi 2000 vetë. Nënshkrimet nuk realizohen përpara ndonjë autoriteti (kushdo qoftë), ndërkohë që ka një përjashtim për partitë që përfaqësojnë minoritetet. Për numrin e nënshkrimeve të nevojshme për regjistrimin e partive politike në zgjedhjet parlamentare në Republikën Italiane, ligji nr. 270, 21 dhjetor 2005 “Ndryshime në normat për zgjedhjen e Dhomës së Deputetëve dhe të Senatit të Republikës” parashikon: “Deklarata sipas paragrafit 1 duhet të jetë e nënshkruar: c) nga të paktën 3500 dhe jo më shumë se 5000 zgjedhës të regjistruar në listat zgjedhore të bashkive të përfshira në rajonet me më shumë se 1 000 000 banorë.” Sipas legjislacionit italian, listat, duke qenë se janë strukturuar sipas rajoneve, paraqiten për autentifikim “për çdo rajon në sekretarinë e gjykatës së apelit ose të gjykatës ku ka selinë zyra zgjedhore rajonale” dhe jo në një strukturë qendrore. Në zyrat e mësipërme që verifikojnë ligjshmërinë e listave, verifikohet

vetëm nënshkrimi i përfaqësuesit partiak (qoftë ky presidenti, sekretari i partisë ose i grupit politik, ose një nga përfaqësuesit e tjerë sipas ligjit) dhe jo ajo e zgjedhësve. Sipas legjislacionit zgjedhor të Mbretërisë së Spanjës (Ley Orgánica 5/1985, de 19 de Junio, Del Régimen Electoral General), rregullimi, për sa më sipër, është shumë i ngjashëm me atë italian, ku listat mbështetëse të partive konkurruese nënshkruhen në bazë rajoni dhe variojnë nga 100 deri në 8000 nënshkrues (këta të fundit në zona me mbi 1 000 000 banorë).

21. Në të dy rastet e parashikuara nga Kodi Zgjedhor, si përpara noterit ashtu edhe në KQZ, rezultojnë se është kusht *sine qua non* për vlefshmërinë e aktit paraqitja individuale e personit nënshkrues. Sipas nenit 55 të ligjit nr.7829, datë 1.6.1994 “Për noterinë”: “Vërtetimi i nënshkrimeve bëhet për akte private që nuk përmbajnë lidhjen e një kontrate ose kryerjen e një veprimi tjetër juridik. Vërtetimi bëhet në fund të aktit, pas nënshkrimeve, duke u bërë shënimi nga noteri se personat u paraqitën personalisht dhe nënshkruan në prani të tij ose pranuan se nënshkrimet janë të tyre. Vërtetimi i nënshkrimeve në kushte të caktuara me ligj mund të bëhet edhe nga organe shtetërore.” Kushti për depozitimin e nënshkrimeve individualisht përpara një noteri ose në KQZ argumentohet nga përfaqësuesit e subjektit të interesuar, Kuvendit, me proceset e integritimit në Europë si një domosdoshmëri për “përmbushjen e detyrimit për dokumentacion të rregullt me çdo kusht dhe pa asnjë pretendim, aq më tepër kur gjithçka bëhet në përputhje dhe në zbatim të ligjeve të shtetit.” Edhe në hipotezën e sugjeruar nga subjekti i interesuar, Këshilli i Ministrave, se të 10 000 nënshkruesit do të paraqiteshin përpara të njëjtit noter – situatë që do të shmange problemin financiar të PBPSH-së, pasi pagesa do të ishte vetëm një (1500 lekë me tarifatat aktuale të miratuara nga Ministria e Drejtësisë), Gjykata thekson se mbetet i pazgjidhur problemi i organizimit, kostoja e transportit dhe kosto të tjera që detyron një kusht i tillë, pasi nënshkruesit do të duhet të udhëtojnë nga zona të ndryshme, çka e barasvlerëson këtë zgjidhje me atë të paraqitjes në KQZ. Nga ana tjetër, Gjykata vlerëson se ka një disproporcion nga pikëpamja e interesit, ndërmjet rregullimit të parashikuar nga Kodi Zgjedhor dhe ligjit nr.8580, datë 17.2.2000 “Për partitë politike”, i cili në nenin 10 parashikon: “Kërkesa për regjistrimin e një partie politike duhet të nënshkruhet nga jo më pak se 500 shtetas shqiptarë, anëtarë themelues të saj, me vendbanim të përhershëm në Republikën e Shqipërisë.”

22. Gjykata çmon se nga ana e përfaqësuesve të subjektit të interesuar, Kuvendit, nuk u ofruan argumente të qëndrueshme lidhur me interesin publik që ka nxitur ligjvënësin të rrisë numrin e individëve nënshkrues/mbështetës nga 7000 që parashikohej në Kodin Zgjedhor të vitit 2003, në 10 000 në Kodin Zgjedhor, objekt shqyrtimi. Në një aspekt, kjo rritje justifikohet me bashkëpunimin e partive të vogla (të reja) me ato të mëdha (të vjetra), të cilat kanë mjaftueshëm deputetë në Kuvend, për të mundësuar edhe regjistrimin e partive që e kanë të pamundur ose të vështirë mbledhjen e një numri kaq të lartë nënshkrimesh. Kjo lëvizje mund të ketë nga njëra anë efektin e vet pozitiv, në drejtim të formatimit të koalicioneve parazgjedhore, të cilat mund të sjellin një trupë legjislativë më të qëndrueshme, por nga ana tjetër, në vlerësimin e Gjykatës, *de facto* përbën një formë detyrimi ndaj partive të vogla për t’iu nënshtruar partive të mëdha.

23. Gjykata vlerëson se zgjedhjet kanë si objektiv të mundësojnë zgjedhësit të zgjedhin përfaqësuesit e tyre, por edhe të sjellin një Kuvend me shumicë të qëndrueshme, që në vijim të mund të prodhojnë legjislacion dhe të mundësojnë një qeverisje efektive. Një sistem proporcional, tërësisht i pakufizuar përballë partive të vogla, mund të ketë potencialisht pasoja destabilizuese.<sup>1</sup> Trajtimi i pabarabartë i partive, duke dalluar ndërmjet tyre partitë brenda dhe jashtë Kuvendit, bëhet për mbrojtjen e votuesit nga shpërdorimi i votës. Gjykata vlerëson se është “një vullnet i ligjshëm i legjislatorit të kërkojë mbrojtjen e votuesit, në mënyrë që ai të mos ia japë votën një kandidati ose oferte të pashpresë. Një sistem zgjedhor që mundëson oferta zgjedhore mund të funksionojë vetëm nëse paraqitja e një oferte nuk është thjesht e drejta e gjithkujt, pa asnjë përgjegjësi të mëtejshme. Vetëm një ofertë që merret seriozisht është një ofertë me kuptim. Numri i nënshkrimeve që duhet të mblidhen sigurisht që mbetet një atribut i ligjvënësist për ta përcaktuar, por ky përcaktim duhet të jetë i drejtë. Gjykata vlerëson se ky numër nënshkruesish nuk duhet të jetë “aq i ulët sa të lejojë gjithkënd të marrë pjesë në konkurrim..., por edhe të mos jetë aq i lartë sa ta bëjë praktikisht të pamundur apo të vështirë për një parti të re pjesëmarrjen në zgjedhje” (Shih më gjerë vendimin e shkurtit të vitit 1956 për ligjin zgjedhor të Baden-Württemberg, të Gjykatës Kushtetuese Gjermane; *Entscheidungen des Bundesverfassungsgerichts*. Volume

<sup>1</sup> *Entscheidungen des Bundesverfassungsgerichts*. Volume 1, pp.247-248.

4, pp.381-384.) Konkurrimi i lirë ndërmjet partive është një shfaqje e drejtpërdrejtë e natyrës pluraliste të shoqërisë demokratike dhe është pikërisht mbrojtja e pluralizmit në jetën politike që ka kuptim për vetë ekzistencën e kësaj shoqërie. Gjykata thekson se çdo kufizim i drejtpërdrejtë ose i tërthortë mbi barazinë e partive në konkurrimin zgjedhor nuk duhet të ketë një pasojë diferencuese ose të përbëjë një trajtim preferencial për disa parti, ose të ndalojë pjesëmarrjen e partive politike në konkurrimin zgjedhor.<sup>2</sup>

24. Gjykata në jurisprudencën e saj ka theksuar: “ ... është tepër e rëndësishme për çdo shtet të së drejtës që zbaton rregullat e një shoqërie demokratike, të gëzojë hapësira të konsiderueshme për të përcaktuar rregulla dhe kritere të drejta brenda rendit të tij kushtetues, në përputhje me kushtet konkrete, si dhe me faktorët e ndryshëm politikë, historikë, socialë, kulturorë, tradicionalë, të cilët janë tepër përcaktues. [...]. Ligjvënësi ka hapësirë veprimi për të vlerësuar vet duke parashikuar në ligj kritere të tilla që i përgjigjen në realitet dhe objektivisht parimit të barazisë së votave dhe përfaqësimit të barabartë. Detyrë e Gjykatës Kushtetuese nuk është që të vihet në rolin e ligjvënësit pozitiv dhe të përcaktojë rregullimet ligjore, por të kontrollojë nëse zgjidhja që jep ligjvënësi nëpërmjet përcaktimeve të kritereve ligjore [...] është ose jo në përputhje me dispozitat e Kushtetutës” (Shih më gjerë vendimin nr.1, datë 7.01.2005 të Gjykatës Kushtetuese).

25. Nga analiza e dispozitave objekt shqyrtimi, Gjykata arrin në përfundimin se gjendemi përpara një kufizimi të pjesëmarrjes në mënyrë të barabartë të partive në zgjedhje. Ky kufizim, për rrjedhojë, ka ndikimin e tij negativ edhe për funksionimin e pluralizmit, parim i mbrojtur nga neni 3 i Kushtetutës. Gjykata vlerëson se nuk ka asnjë arsye të dukshme kushtetuese për të krijuar një dallim të këtij dimensionit (joproporcional) ndërmjet partive politike, kandidatët e të cilave janë zgjedhur në Kuvend (partitë parlamentare) dhe partive të tjera (joparlamentare), çka realisht bëhet përmes neneve 68 e 71 të Kodit Zgjedhor (2008).

Gjykata vlerëson se një rregullim i tillë, duke qenë joproporcional, nuk mund të justifikohet me ndonjë interes publik, me pengimin e fragmentarizmit të tepruar të partive politike, por dhe as me synimin për të siguruar kandidatura serioze në zgjedhje ose përjashtimin e atyre që nuk kanë mundësi suksesi. Përmes këtij rregullimi, ligjvënësi krijon pabarazi ndërmjet partive politike për një konkurrim të drejtë ndërmjet tyre.

#### PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, duke u bazuar te neni 131, shkronja “a” i Kushtetutës, si dhe te nenet 49, 50, 51, 72 e 76 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, me shumicë votash,

#### VENDOSI:

1. Shfuqizimin si të papajtuësëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, në nenin 68 të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” të fjalisë: “Listat e kandidatëve për Kuvendin, të paraqitura nga partitë politike, të cilat nuk zotërojnë asnjë mandat në Kuvend, duhet të mbështeten nga jo më pak se 10 000 zgjedhës.”

2. Shfuqizimin si të papajtuësëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, në nenin 71 të Kodit Zgjedhor, të fjalisë: “Zgjedhësit depozitojnë në mënyrë individuale nënshkrimet e tyre për mbështetjen e kandidatit të propozuar nga një grup zgjedhësish apo për partitë dhe koalicionet e parashikuara në nenet 68 dhe 69 të këtij Kodi në KQZ apo përpara noterit.”

3. Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë pro: Kujtim Puto, Fehmi Abdiu, Petrit Pllloçi, Sokol Sadushi, Sokol Berberi

Anëtarë kundër: Vladimir Kristo (kryetar), Vitore Tusha, Xhezair Zaganjori, Admir Thanza

<sup>2</sup> CZE-2000-1-002 (Codices).

**VENDIM**  
**Nr.33, datë 24.6.2010**

**NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Vladimir Kristo	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese,
Fehmi Abdiu	Anëtar i “ “
Kujtim Puto	Anëtar i “ “
Xhezair Zaganjori	Anëtar i “ “
Petrit Ploçi	Anëtar i “ “
Vitore Tusha	Anëtare e “ “
Sokol Sadushi	Anëtar i “ “
Sokol Berberi	Anëtar i “ “
Admir Thanza	Anëtar i “ “

me sekretare Blerina Çinari, në datë 03.11.2009 mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr. 23, 24, 25, 29 /14 Akti, që i përket:

**KËRKUES:SHOQATA KOMBËTARE E USHTARAKËVE NË REZERVË**, përfaqësuar nga av.Anastas Duro, me autorizim.

**AVOKATI I POPULLIT**, përfaqësuar nga Alma Vokopola, Alket Jaupi dhe Sotiraq Nushi, me autorizim.

**SINDIKATA E PUNONJËSVE TË POLICISË SË SHTETIT**, përfaqësuar nga av.Thimio Kondi, av.Viktor Ikonomi dhe av.Rigels Konomi, me autorizim.

**SHOQATA “ORGANIZATA E PUNONJËSVE TË POLICISË SË SHTETIT NË LIRIM”**, përfaqësuar nga av.Thimio Kondi, av.Viktor Ikonomi dhe av.Rigels Konomi, me autorizim.

**SUBJEKTE TË INTERESUARA: SHOQATA “ALEANCA KOMBËTARE E USHTARAKËVE TË SHQIPËRISË”**, përfaqësuar nga Kujtim Çaku.

**KUVENDI I SHQIPËRISË**, përfaqësuar nga znj.Jonida Tafani dhe z.Bledar Miloti, me autorizim.

**KËSHILLI I MINISTRAVE**, përfaqësuar nga zj.Marsida Xhaferllari, me autorizim.

**MINISTRIA E FINANCAVE**, përfaqësuar nga zj. Lindita Rusmali, me autorizim.

**MINISTRIA E MBROJTJES**, përfaqësuar nga z. Rezart Tërshana, z.Gjergji Pihoni dhe z.Leonard Kryeziu, me autorizim.

**INSTITUTI I SIGURIMEVE SHOQËRORE**, përfaqësuar nga z. Ali Emini, me autorizim.

**QENDRA SHQIPTARE E REHABILITIMIT TË TRAUMËS DHE TORTURËS**, në mungesë.

**OBJEKTI: 1.** Shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë të ligjit nr.10142, datë 15.05.2009 "Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura, të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit Informativ të Shtetit, të Policisë së Burgjeve, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit e të punonjësve të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm në Republikën e Shqipërisë".

**2.** Pezullimi i zbatimit të ligjit nr.10142, datë 15.05.2009 "Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura, të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit Informativ të Shtetit, të Policisë së Burgjeve, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit e të punonjësve të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm në Republikën e Shqipërisë" deri në dhënien e vendimit përfundimtar nga Gjykata Kushtetuese.

**BAZA LIGJORE:** Nenet 4, 15/1, 17/1,2, 18/1,3, 49/2, 52/1, 131/a, 134/1/“f”, 142/3, 166/1, 167/2 dhe 168/1 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; nenet 27-31, 45, 49/2 dhe 51 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë"; neni 24, shkronja "c" i ligjit nr.8454, datë 4.2.1999 "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar me ligjin nr. 9398, datë 12.05.2005.

## GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes, Admir Thanza, përfaqësuesit e kërkuësve dhe përfaqësuesin e subjektit të interesuar: shoqata "Aleanca Kombëtare e Ushtarakëve të Shqipërisë" që u shprehën për pranimin e kërkesës, përfaqësuesit e subjekteve të interesuara: Kuvendi i Shqipërisë, Këshilli i Ministrave, Ministria e Financave, Ministria e Mbrojtjes dhe Instituti i Sigurimeve Shoqërore që kërkuan rrëzimin e kërkesës dhe, pasi diskutoi çështjen në tërësi,

### VËREN:

#### I

Ligji nr.10142, datë 15.05.2009 "Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura, të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit Informativ të Shtetit, të Policisë së Burgjeve, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit e të punonjësve të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm në Republikën e Shqipërisë" (ligji objekt gjykimi) ndryshoi kuadrin ligjor ekzistues për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve dhe të punonjësve të Policisë së Shtetit në detyrë ose në lirim.

**Kërkuesi**, Shoqata Kombëtare e Ushtarakëve në Rezervë, përpara Gjykatës Kushtetuese (Gjykata) kërkon shfuqizimin e ligjit objekt gjykimi me pretendimin se ai është i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë (Kushtetuta), pasi bën një rregullim të ndryshëm përkeqësues nga ligjet e mëparshme: Ligji nr.9210, datë 23.03.2004 "Për statusin e ushtarakut të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë"; ligji nr.7703, datë 11.05.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë"; ligji nr.9418, datë 20.05.2005 "Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë" (të ndryshuar), dhe me vendimin nr.9, datë 26.02.2007 të Gjykatës Kushtetuese, duke parashtruar në mënyrë të përmbledhur këto pretendime:

- Ligji objekt gjykimi cenon parimin e barazisë përpara ligjit pasi krijon një diskriminim ndërmjet ushtarakëve që kanë paguar kontributin shtesë prej 2% dhe atyre që nuk e kanë paguar, ushtarakëve që kanë vjetërsi shërbimi më pak se 15 vjet për burrat dhe 12 vjet për gratë dhe diskriminon ushtarakët që janë dënuar për motive politike, si dhe ndërmjet ushtarakëve dhe qytetarëve të tjerë të Republikës së Shqipërisë.

- Ligji objekt gjykimi cenon parimin e sigurisë juridike, pasi zvogëlon të drejtat e fituara nga ushtarakët, cenon vendimet gjyqësore të formës së prerë dhe u jepet fuqi prapavepruese.

**Kërkuesi**, Avokati i Popullit, përpara Gjykatës, kërkon shfuqizimin e neneve 3/3, 4/2, 12/1,2,3, 14/1, 22, 27, dhe 29/2 të ligjit nr.10142, datë 15.05.2009 si të papajtueshme me Kushtetutën, duke parashtruar në mënyrë të përmbledhur këto pretendime:

- Ligji në nenin 27 të tij cenon parimin e barazisë përpara ligjit, pasi diskriminon ushtarakët që janë dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë me burgim, për krime të kryera me dashje, si dhe trajton me kritere të barabarta punonjësit e Policisë së Shtetit me punonjësit e strukturave të tjera, kur në fakt kushtet dhe vështirësitë e punës janë të ndryshme.

- Ligji cenon parimin e sigurisë juridike, pasi zvogëlon të drejtat e fituara nga punonjësit e Policisë së Shtetit, cenon vendimet gjyqësore të formës së prerë, ka fuqi prapavepruese dhe rrit masën e kontributit suplementar që punonjësit e Policisë së Shtetit duhet të paguajnë.

**Kërkuesi**, Sindikata e Punonjësve të Policisë së Shtetit, përpara Gjykatës, kërkon shfuqizimin e neneve 3/3, 4/2, 12/1,2,3, 14/1, 22, 27 dhe 29/2 të ligjit nr. 10142, datë 15.05.2009 si të papajtueshme me Kushtetutën, duke parashtruar në mënyrë të përmbledhur këto pretendime:

- Ligji cenon standardin kushtetues të një procesi të rregullt ligjor të sanksionuar në nenin 42/1 të Kushtetutës, pasi është miratuar në shkelje të hapur të procedurës për miratimin e tij të parashikuar në Rregulloren e Kuvendit.

- Ligji në nenin 27 të tij cenon parimin e barazisë përpara ligjit, pasi diskriminon ushtarakët që janë dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë me burgim, për krime të kryera me dashje.

- Ligji cenon parimin e sigurisë juridike, pasi zvogëlon të drejtat e fituara nga punonjësit e Policisë së Shtetit, cenon vendimet gjyqësore të formës së prerë, ka fuqi prapavepruese dhe rrit masën e kontributit suplementar që punonjësit e Policisë së Shtetit duhet të paguajnë.



**Kërkuesi**, shoqata “Organizata e punonjësve të Policisë së Shtetit në lirim”, përpara Gjykatës, kërkon shfuqizimin e ligjit nr. 10142, datë 15.05.2009 objekt të gjykimit, si të papajtueshme me Kushtetutën, duke parashtruar në mënyrë të përmbledhur këto pretendime:

- Ligji cenon standardin kushtetues të një procesi të rregullt ligjor të sanksionuar në nenin 42/1 të Kushtetutës, pasi është miratuar në shkelje të hapur të procedurës të parashikuar në Rregulloren e Kuvendit.

- Ligji është në kundërshtim me nenin 49/2 të Kushtetutës, sepse cenon të drejtën e mbrojtjes shoqërore të punës, pasi pakëson të drejta me karakter ekonomik e social të fituara nga punonjësit e Policisë së Shtetit.

- Ligji cenon parimin e barazisë përpara ligjit, pasi vendos një lloj barazie në përfitime ndërmjet punonjësve të policisë që kanë grada më të larta dhe që paguajnë më shumë kontribute dhe atyre që kanë grada dhe paga më të ulëta dhe që paguajnë më pak kontribute.

- Ligji cenon parimin e sigurisë juridike, pasi zvogëlon të drejtat e fituara nga punonjësit e Policisë së Shtetit; cenon vendimet gjyqësore të formës së prerë dhe ka fuqi prapavepruese.

**Subjekti i interesuar**, shoqata “Aleanca Kombëtare e Ushtarakëve të Shqipërisë” depozitoi pranë Gjykatës Kushtetuese një kërkesë për t’u thirrur si subjekt i interesuar. Në vijim të kësaj kërkesë kjo shoqatë është njoftuar nga Gjykata Kushtetuese për t’u paraqitur ditën e seancës. Gjatë seancës, përfaqësuesi i këtij subjekti deklaroi se ky subjekt dëshironte të merrte pjesë në cilësinë e subjektit të interesuar, duke u bashkuar me kërkuesit për antikushtetutshmërinë e ligjit dhe duke parashtruar këto pretendime:

- Neni 30 i ligjit nr.10142, datë 15.05.2009 shfuqizon dispozita të ligjit nr.9210, datë 23.3.2004 "Për statusin e ushtarakut të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë", i cili është një ligj organik që mund të ndryshohet vetëm me një shumicë prej 3/5 votash.

- Ligji cenon parimin e barazisë përpara ligjit, pasi diskriminon ushtarakët, duke i barazuar me përfituesit e tjerë që nuk janë ushtarakë.

- Ligji cenon parimin e sigurisë juridike, pasi cenon të drejtat e fituara nga ushtarakët dhe kufizon masën e pensionit në dy pensione bazë, pavarësisht gradave të përfituesve.

Përfaqësuesit e **subjekteve të interesuara** Këshilli i Ministrave, Kuvendi i Shqipërisë, Ministria e Financave, Ministria e Mbrojtjes, Instituti i Sigurimeve Shoqërore dhe Qendra Shqiptare e Rehabilitimit të Traumës dhe Torturës kërkuan rrëzimin e kërkesave, duke parashtruar në mënyrë të përmbledhur:

- Kërkuesit nuk legjitimohen për të vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese. Avokati i Popullit nuk ka interes në çështjen konkrete, kurse kërkuesit e tjerë nuk specifikojnë në kërkesat e tyre dispozitat statutoare, në bazë të të cilave këto organizata mbrojnë interesat ekonomikë të anëtarëve të tyre.

- E drejta për përfitim suplementar është një e drejtë që është vlerësuar nga Kuvendi, se meriton mbrojtje me ligj, por ky fakt nuk nënkupton se përfshihet në rrethin e të drejtave kushtetuese dhe të lirive themelore.

- Ligji objekt gjykimi nuk cenon parimin e sigurisë juridike, pasi ai nuk vendos detyrime për shtetasit, por u garanton atyre përfitime suplementare, duke mos prekur nevojat jetike të subjekteve që e kanë fituar më parë këtë të drejtë. Ligji objekt gjykimi ndjek një interes publik, pasi zgjerohet kategoria e subjekteve përfituese, rriten përfitimet për disa kategori përfituesish dhe reformohen Forcat e Armatosura sipas standardeve të NATO-s. Ky zgjerim imponon ndryshimin e masës së përfitimit, por jo mohimin e saj, pasi të ardhurat që vijnë nga kontributet e vetë punonjësve kanë nevojë të plotësohen me të ardhura shtesë nga Buxheti i Shtetit. Ligji objekt gjykimi nuk cenon nenin 142/3 të Kushtetutës, pasi nuk anulon përfitimin e pensionit të fituar me vendim gjykate, por thjesht e rillogarit atë.

- Ligji objekt gjykimi nuk cenon parimin e barazisë përpara ligjit, sepse përfitimet llogariten në bazë të pagës referuese, e cila është e ndryshme për nivele të ndryshme të funksioneve shtetërore dhe për pasojë përfitimi është i diferencuar, për shkak të diferencimit edhe në nivelin e kontributeve.

- Ligji objekt gjykimi nuk cenon të drejtën për mbrojtje shoqërore të punës, pasi neni 49 i Kushtetutës nuk mbron të drejtën për përfitime suplementare, por të drejtën e fitimit të mjeteve të jetesës me punë të ligjshme dhe me zgjedhjen e lirë të profesionit dhe vendit të punës.

- Sa i përket pretendimit për cenimin e standardit kushtetues për një proces të rregullt ligjor, të sanksionuar në nenin 42/1 të Kushtetutës, ky pretendim nuk është arritur të provohet nga kërkuesit përpara Gjykatës Kushtetuese.

## II

Gjykata mori paraprakisht në shqyrtim, përpara seancës plenare, kërkesën për pezullimin e zbatimit të ligjit nr.10142, datë 15.05.2009 "Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura, të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit Informativ të Shtetit, të Policisë së Burgjeve, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit e të punonjësve të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm në Republikën e Shqipërisë". Në kuptim të nenit 45 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", subjekti që kërkon pezullimin e një akti duhet të provojë nëse zbatimi i menjëhershëm i tij do të prekë interesat shtetërorë, shoqërorë ose të individëve, si dhe pasojat e pariparueshme që do të sillte zbatimi i aktit. Gjykata nuk gjeti argumente bindëse për mundësinë e ardhjes së pasojave të dëmshme për interesat shtetërorë e shoqërorë ose të individëve, si rrjedhojë e zbatimit të menjëhershëm të këtij ligji, në kuptim të nenit 45 të ligjit të sipërcituar. Për këto arsye Mbledhja e Gjyqtarëve vendosi rrëzimin e kësaj kërkesë.

## III

### **1. Lidhur me pretendimin e subjekteve të interesuara se kërkuessit nuk legjitimohen për të vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetues**

#### **1.1 Për legjitimitimin e Avokatit të Popullit**

Gjykata vëren se e drejta e Avokatit të Popullit për të iniciuar një gjykim kushtetues ka tashmë një trajtim të qëndrueshëm në jurisprudencën kushtetuese. Avokati i Popullit, si një nga subjektet që mund të vërë në lëvizje Gjykatën, në bazë të nenit 134/2 të Kushtetutës, duhet të justifikojë interesin e tij në çështjen konkrete dhe që lidhet me ushtrimin e funksionit të tij kushtetues për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të individëve nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme ose të parregullta të organeve të administratës publike. Kur gjatë shqyrtimit të ankesave, kërkesave ose njoftimeve që i paraqiten, Avokati i Popullit evidenton shkeljet, nga ato të sipërcituara, rekomandon, nëse është e nevojshme, marrjen e masave me karakter normativ. Krahas kësaj, një mënyrë tjetër, me të cilën ky organ realizon funksionin e tij në mbrojtje të të drejtave dhe lirive themelore të shtetasve, është dhe vënia në lëvizje e Gjykatës për shfuqizimin e akteve normative, të nxjerra nga organet e administratës publike dhe që rezultojnë të jenë në papajtueshmëri me Kushtetutën. Në raste të tilla, Avokati i Popullit duhet të argumentojë shkeljen konkrete dhe interesin në çështjen që kërkon të shqyrtohet. (*Shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr.40, datë 16.11.2007*).

Për rastin në shqyrtim, Gjykata vëren se pretendimi i subjekteve të interesuara për mungesë të interesit të Avokatit të Popullit, është i bazuar dhe duhet të pranohet pjesërisht vetëm për sa i takon pretendimit të tij për antikushtetueshmërinë e nenit 27 të ligjit objekt gjykimi. Gjykata vëren se Avokati i Popullit, në kërkesën paraqitur Gjykatës, shprehet se është vënë në lëvizje nga "*Sindikata e punonjësve të Policisë së Shtetit dhe 21 qytetarë (punonjës të Policisë së Shtetit në detyrë dhe ish-punonjës të Policisë së Shtetit, të cilët trajtohen me pagesë kalimtare apo me pension të parakohshëm për vjetërsi shërbimi)*". Gjykata vlerëson se neni 27 i ligjit objekt gjykimi nuk përmban dispozita që rregullojnë të drejtat e punonjësve të Policisë së Shtetit, por të ushtarakëve të Forcave të Armatosura. Në zbatim të vendimeve të saj të mëparshme Gjykata rithekson se Avokati i Popullit mund të vërë në lëvizje këtë Gjykatë vetëm nëse gjatë shqyrtimit të ankesave, kërkesave ose njoftimeve që i paraqiten evidenton shkelje të të drejtave dhe lirive themelore të individëve.

Gjykata Kushtetuese vëren, gjithashtu, se interesi i Avokatit të Popullit për të vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese, në kuptim të nenit 134/2 të Kushtetutës, duhet të shqyrtohet rast pas rasti. Gjykata Kushtetuese është shprehur dhe më parë në praktikën e saj, se interesi i subjekteve që legjitimohen për të vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese sipas shkronjave "dh", "e" "ë", "f" të nenit 134 të Kushtetutës, do të quhet i justifikuar nëse arrin të provohet nga vetë kërkuessi se pasoja është e drejtpërdrejtë, pra rrjedh drejtpërdrejt nga akti objekt shqyrtimi, është aktuale dhe, sipas rastit, është e lidhur ngushtë me detyrat dhe funksionet e institucionit ose të organizatës përkatëse (Shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr.40, datë 16.11.2007). Avokati i Popullit nuk arriti të provojë që të drejtat që rregullohen nga neni 27 i ligjit objekt gjykimi, kanë qenë objekt i veprimtarisë konkrete të tij. Për sa më sipër, Gjykata vlerëson se kërkuessi Avokati i Popullit nuk ka interes për ngritjen e këtij pretendimi. Por Gjykata vlerëson se Avokati i Popullit legjitimohet për ngritjen e pjesës tjetër të pretendimeve që i përkasin cenimit të të drejtave të punonjësve të Policisë së Shtetit, përderisa provon se shkeljet e pretenduara përpara Gjykatës i

ka evidentuar gjatë shqyrtimit të ankesave të Sindikatës së Punonjësve të Policisë së Shtetit dhe 21 punonjësve të Policisë së Shtetit në detyrë a në lirim, duke karakterizuar kështu ekzistencën e lidhjes së drejtpërdrejtë ndërmjet pretendimeve të ngritura përpara Gjykatës dhe funksioneve të tij të parashikuara nga Kushtetuta.

### *1.2 Për legjitimitimin e kërkuësve të tjerë*

Gjykata Kushtetuese ka interpretuar, në jurisprudencën e saj, kriteret kushtetuese për legjitimitimin e organizatave si subjekte që mund ta venë atë në lëvizje (*Shih vendimet e Gjykatës Kushtetuese nr.9, datë 19.03.2008; nr.41, datë 16.11.2007; nr.35, datë 10.10.2007; nr.11, datë 4.04.2007; nr. 9, datë 26.02.2007*). Shoqatat ose organizatat e tjera janë përcaktuar në nenin 134, pika 1, shkronja “f” të Kushtetutës si subjekte që ushtrojnë në mënyrë të kushtëzuar të drejtën për t’iu drejtuar Gjykatës, duke pasur legjitimitet kushtetues vetëm për çështjet që lidhen me interesat e tyre (*Shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr.35, datë 10.10.2007*). Ato kanë detyrimin për të provuar lidhjen e domosdoshme, të drejtpërdrejtë dhe të individualizuar që duhet të ekzistojë ndërmjet veprimtarisë ligjore që ato kryejnë dhe çështjes kushtetuese të ngritur. Interesi për të vepruar duhet të jetë i sigurt, i drejtpërdrejtë dhe vetjak.

Shoqata Kombëtare e Ushtarakëve në Rezervë, shoqata “Aleanca Kombëtare e Ushtarakëve të Shqipërisë”, Sindikata e Punonjësve të Policisë së Shtetit dhe shoqata “Organizata e Punonjësve të Policisë së Shtetit në Lirim” janë subjekte juridike të regjistruara në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, përkatësisht me vendimet nr.2250, datë 25.03.1996; nr.2644, datë 30.09.2009, nr.3716, datë 17.05.2007 dhe nr.1942, datë 22.04.2007.

Gjykata vëren se sipas statutit të secilit prej kërkuësve të sipërcituar, në objektin e veprimtarisë përfshihet mbrojtja e interesave socialë-ekonomikë të anëtarëve të tyre. Kërkuësit pretendojnë se ligji objekt i këtij gjykimi pranë Gjykatës dëmton interesat ekonomikë të anëtarëve të tyre nëpërmjet pakësimit të përfitimeve suplementare dhe cenimit të të drejtave të fituara. Gjykata vëren se ligji objekt gjykimi parashikon një rregullim të ri të përfitimeve suplementare që gëzohen ose do të gëzohen nga anëtarët e kërkuësve, duke karakterizuar kështu lidhjen e drejtpërdrejtë ndërmjet veprimtarisë ligjore që ato kryejnë dhe çështjes kushtetuese të ngritur. Por Gjykata vëren se kjo lidhje e drejtpërdrejtë nuk ekziston në rastin e pretendimit të ngritur nga kërkuësi Sindikata e Punonjësve të Policisë së Shtetit përse i përket cenimit të parimit të barazisë përpara ligjit nga neni 27 i ligjit objekt gjykimi. Gjykata vlerëson se neni 27 nuk përmban dispozita që rregullojnë përfitimet e punonjësve të Policisë së Shtetit, të drejtat e të cilëve mbrohen nga kërkuësi, por vetëm të ushtarakëve të Forcave të Armatosura.

Sa më sipër Gjykata vlerëson se, me përjashtim të pretendimit të Avokatit të Popullit dhe Sindikatës së Punonjësve të Policisë së Shtetit për cenimin e parimit të barazisë përpara ligjit nga neni 27 i ligjit objekt gjykimi, kërkuësit dhe subjekti i interesuar shoqata “Aleanca Kombëtare e Ushtarakëve të Shqipërisë” legjitimohen përpara kësaj gjykate për inicimin e këtij gjykimi kushtetues.

### ***2. Lidhur me pretendimin se ligji objekt gjykimi cenon standardin kushtetues të një procesi të rregullt ligjor të sanksionuar në nenin 42/1 të Kushtetutës***

Kërkuësit Sindikata e Punonjësve të Policisë së Shtetit dhe shoqata “Organizata e Punonjësve të Policisë së Shtetit në lirim” ngritën pretendimin në seancë se ligji objekt i gjykimit duhet shpallur antikushtetues, për arsye se është miratuar duke shkelur standardin kushtetues të një procesi të rregullt ligjor të sanksionuar në nenin 42/1 të Kushtetutës. Ata argumentuan se ligji objekt i kërkesës është miratuar në shkelje të hapur të procedurës për miratimin e tij të parashikuar në Rregulloren e Kuvendit (nenet 19, 70 dhe 69 të kësaj Rregulloreje).

Gjykata ka trajtuar në vendimet e saj të mëparshme natyrën juridike të Rregullores së Kuvendit. Gjykata ka vlerësuar se Rregullorja e Kuvendit është një akt juridik në të cilin gjejnë pasqyrim disa dispozita të nivelit kushtetues dhe ka si qëllim të vendosë rregulla mbi veprimtarinë dhe funksionimin e brendshëm të Kuvendit. Gjykata rithekson se Rregullorja e Kuvendit mund të jetë objekt kontrolli kushtetues vetëm nëse janë prekur dispozita të nivelit kushtetues që gjejnë pasqyrim në të. Për çështje të tjera Rregullorja e Kuvendit nuk mund të jetë objekt i një kontrolli të tillë (Shih vendimin nr.35, datë 10.10.2007 të Gjykatës Kushtetuese). Gjykata e vlerëson të drejtë parashtrimin e subjekteve të interesuara Këshilli i Ministrave dhe Kuvendi, se shkeljet e pretenduara nga kërkuësit nuk janë të karakterit procedural të nivelit kushtetues, por të karakterit procedural të parashikuar vetëm në Rregulloren e Kuvendit.

Gjithashtu, Gjykata e vlerëson të drejtë parashtrimin e subjekteve të interesuara, Këshilli i Ministrave dhe Kuvendi, se kërkuessit në mbështetje të këtij pretendimi nuk arrihen të provonin se janë prekur ato pjesë të Rregullores së Kuvendit që cenojnë standardet kushtetuese. Gjykata vëren se kërkuessit madje nuk sollën as provën se i janë drejtuar institucionit të Kuvendit, për të kërkuar shpjegime ose elemente për këto fakte. Në kushtet kur kërkuessit nuk kanë bërë asnjë përpjekje zyrtare për të siguruar provën mbi të cilën mbështesin pretendimin e tyre, nuk i takon Gjykatës të kryejë këto përpjekje në mungesë të një dyshimi të përligjur të krijuar nga elemente konkrete.

Sa më sipër Gjykata Kushtetuese vlerëson se ky pretendim nuk mund të pranohet.

### ***3. Lidhur me pretendimin se ligji objekt gjykimi shkel nenin 49/2 të Kushtetutës pasi cenon të drejtën e mbrojtjes shoqërore të punës***

Kërkuessi shoqata “Organizata e punonjësve të Policisë së Shtetit në lirim” pretendon se ligji objekt gjykimi cenon të drejtën e mbrojtjes shoqërore të punës, pasi pakëson të drejta me karakter ekonomik e social të fituara nga punonjësit e Policisë së Shtetit. Kërkuessi shprehet se përmirësimi në mënyrë të vazhdueshme i kushteve të jetesës dhe garantimi i standardeve të arritura përbën një ndër objektivat më të rëndësishëm ekonomik-social të shtetit tonë, si shtet i së drejtës, demokratik e social.

Gjykata është shprehur se e drejta për pension është një e drejtë që përfshihet në grupin e të drejtave ekonomik-socialë që për nga natyra janë të drejta pozitive. Prandaj përmbajtja e tyre duhet interpretuar në lidhje të ngushtë me detyrimin e shtetit për t’u bërë aktiv e për t’u garantuar shtetasve sigurimin e mjeteve të përshtatshme për nevojat jetësore në rastet e fatkeqësive, të sëmundjeve, invaliditetit, pleqërisë dhe papunësisë së padëshiruar (*Shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr.9, datë 26.02.2007*).

Gjykata, për vlerësimin e cenimit të së drejtës për mbrojtje shoqërore të punës, nuk mund të shqyrtojë ligjin objekt gjykimi si të shkëputur nga legjislacioni shqiptar në të cilin ai bën pjesë. Ky ligj u njeh përfituesve të drejta suplementare, në formën e pensionit, mbi ato që u burojnë nga ligji nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”.

Gjykata vëren se ligji objekt gjykimi nuk e ndryshon ligjin nr.7703, datë 11.05.1993, por ai ul përfitimet suplementare për disa kategori përfituesish.

Gjykata vëren se ligji objekt gjykimi nuk cenon parimin e mbrojtjes shoqërore të punës, pasi asnjë nga përfituesit e ligjit nuk e ka humbur mbrojtjen shoqërore të punës të garantuar nga Kushtetuta.

Kërkuessi ka ngritur pretendimin se përfitimet shoqërore janë zvogëluar, por nuk ka paraqitur argumente për të provuar se ky zvogëlim ka qenë në atë masë sa të konsiderohet mohim i së drejtës për mbrojtje shoqërore të punës. Për këtë arsye ky pretendim është i pambështetur dhe për rrjedhojë duhet rrëzuar.

### ***4. Lidhur me pretendimin se ligji objekt gjykimi cenon parimin e barazisë përpara ligjit, sipas nenit 18 të Kushtetutës***

Kërkuessi Shoqata Kombëtare e Ushtarakëve në Rezervë pretendon se ligji objekt gjykimi krijon një diskriminim ndërmjet ushtarakëve që kanë paguar kontributin suplementar prej 2% dhe atyre që nuk e kanë paguar, si dhe ndërmjet ushtarakëve që kanë vuajtur dënime politike dhe atyre që nuk kanë vuajtur të tilla dënime.

Gjykata thekson se parimi i barazisë, i parashikuar në nenin 18 të Kushtetutës, kërkon që të gjithë qytetarët të jenë të barabartë përpara ligjit, jo vetëm në të drejtat themelore të parashikuara në Kushtetutë, por edhe në të drejtat e tjera ligjore. Nga ana tjetër, Kushtetuta, duke sanksionuar parimin e barazisë para ligjit, nuk i ka dhënë asaj kuptimin e një të drejte absolute, sepse ajo ka përcaktuar njëkohësisht edhe kushtet e kufizimit në ushtrimin e kësaj të drejte. Paragrafi i tretë i nenit 18 të Kushtetutës pranon kufizimet e së drejtës për barazi me përmbushjen e disa kushteve të posaçme, të cilat duhet të jenë të përligjura në mënyrë të arsyeshme dhe objektive (*Shih vendimet e Gjykatës Kushtetuese nr.9, datë 26.02.2007; nr.18, datë 29.07.2008*).

Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut, në jurisprudencën e saj, ka theksuar se dallimi në trajtim do të konsiderohet diskriminues, në vështrim të standardeve të nenit 14 të Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut, kur ai “... nuk ka justifikim të arsyeshëm e objektiv”, pra kur ai nuk ndjek një “qëllim të ligjshëm” ose kur nuk ekziston “... marrëdhënie e arsyeshme dhe përpjesëtimore ndërmjet mjeteve të përdorura dhe qëllimit që synohet të arrihet” (*Shih vendimet e Gjykatës Kushtetuese nr.19, datë 9.07.2009; nr.18, datë 29.07.2008*).

Gjykata vëren se ligji i kundërshtuar bën një trajtim të diferencuar ndërmjet ushtarakëve që kanë paguar kontributin suplementar prej 2% dhe atyre që nuk e kanë paguar këtë kontribut, si dhe ndërmjet ushtarakëve që janë dënuar për motive politike dhe atyre që nuk janë dënuar. Parimi i barazisë përpara ligjit kërkon ndërmjet të tjerave mosdiskriminimin e grupeve në kushte të njëjta të shtetasve pa arsye të përligjura. Ky parim kërkon që të gjitha subjektet të trajtohen në mënyrë të njëjtë, por nuk formulon ndalime që të mund të bëhet trajtim i diferencuar, kur individët e grupet nuk ndodhen në kushte të njëjta ose të ngjashme, ose kur ka justifikim të arsyeshëm e objektiv, duke vendosur një raport të arsyeshëm dhe përpjesëtimor midis mjeteve të përdorura dhe qëllimit që synohet të arrihet.

Në nenin 5 të ligjit nr.9210, datë 23.3.2004 "Për statusin e ushtarakut të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë" pranohet se ushtarakët e gëzojnë në mënyrë të njëllajtë statusin si ushtarak, pavarësisht nëse kanë paguar kontributin prej 2% ose kanë vuajtur burgim për motive politike prandaj, parimisht, nuk lihet vend për krijimin e ndonjë ndarjeje bazuar në këto kritere.

Gjykata vëren se ligji objekt gjykimi në nenin 14 pika 2 parashikon një masë më të lartë përfitimi të pensionit të parakohshëm për vjetërsi shërbimi për ushtarakët që kanë paguar kontributin suplementar prej 2%. Gjykata vlerëson se ky diferencim është i mbështetur mbi një kriter të arsyeshëm dhe objektiv në kuptim të standardeve të përmendura më sipër, pasi në nenin 5 të ligjit objekt gjykimi parashikohet se përfitimet suplementare financohen pjesërisht nga Buxheti i Shtetit dhe pjesërisht nga kontributet suplementare të derdhura nga ushtarakët gjatë kohës që ata janë aktivë. Gjykata vlerëson se është i përligjur dhe i arsyeshëm vendimi i ligjvënësist që ushtarakët që kanë kontribuar më shumë gjatë kohës që kanë qenë aktivë të gëzojnë një përfitim më të lartë sesa ata që nuk kanë kontribuar në të njëjtën masë.

Në mbështetje të pretendimit të cenimit të parimit të barazisë përpara ligjit, kërkuesi pretendon, gjithashtu, se ligji objekt gjykimi u mohon të drejtën e përfitimit të pensionit suplementar të pleqërisë atyre ushtarakëve që kanë vjetërsi shërbimi më pak se 15 vjet për burrat dhe 12 vjet për gratë, të njohur me ligjet e mëparshme, ndërkohë që ua njeh këtë të drejtë ushtarakëve të dënuar për motive politike.

Gjykata vëren se ky argument është i pabazuar në ligj, për arsye se në të kundërt nga sa argumenton kërkuesi, ligji objekt gjykimi nuk e lidh përfitimin ose jo të pensionit suplementar të pleqërisë me numrin e viteve të shërbimit në Forcat e Armatosura. Neni 15 i këtij ligji shprehet qartë se "*ushtarakët e Forcave të Armatosura [...] që përfitojnë pension pleqërie, sipas ligjeve nr.4171, datë 13.9.1966 "Për sigurimet shoqërore në Republikën Popullore të Shqipërisë" dhe nr.7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, gëzojnë të drejtën e një pensioni suplementar pleqërie*". Rrjedhimisht ligji objekt gjykimi nuk përjashton nga përfitimi i pensionit suplementar të pleqërisë asnjë ushtarak të Forcave të Armatosura, pavarësisht nga periudha e shërbimit të tij.

I pambështetur është, gjithashtu, edhe argumenti se ligji objekt gjykimi shkel parimin e barazisë përpara ligjit, pasi krijon një diskriminim ndërmjet qytetarëve të tjerë të Republikës së Shqipërisë dhe qytetarit ushtarak, në disfavor të këtij të fundit, duke parashikuar një afat më të shkurtër për tërheqjen e përfitimeve suplementare sesa ai i përfitimeve bazë sipas ligjit nr.7703, datë 11.5.1993.

Gjykata vëren se ligji objekt gjykimi nuk ka të njëjtin objekt me ligjin nr.7703, datë 11.5.1993. Ligji objekt gjykimi ka si qëllim garantimin e përfitimeve suplementare mbi ato të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993. Gjykata vëren se të dy ligjet garantojnë përfitime të një natyre të ndryshme. Gjithashtu, Gjykata vëren se përfituesit ushtarakë të Forcave të Armatosura përfitojnë në të njëjtat kushte me të gjithë qytetarët e tjerë nga ligji nr.7703, datë 11.5.1993. Për këto arsye Gjykata e gjen argumentin të pambështetur në ligj.

Kërkuesi shoqata "Organizata e punonjësve të Policisë së Shtetit në lirim" pretendoi se ligji objekt gjykimi shkel parimin kushtetues të barazisë përpara ligjit, pasi barazon përfitimet e punonjësve të policisë që kanë grada më të larta dhe paguajnë më shumë kontribute dhe atyre që kanë grada dhe paga më të ulëta dhe paguajnë më pak kontribute. Një pretendim i ngjashëm u paraqit nga subjekti i interesuar shoqata "Aleanca Kombëtare e Ushtarakëve të Shqipërisë", e cila pretendoi se ligji objekt gjykimi diskriminon ushtarakët, duke i barazuar me përfituesit e tjerë që nuk janë ushtarakë. Sipas kërkuesve, parimi i barazisë përpara ligjit duhet të interpretohet se përfshin jo vetëm detyrimin e shtetit për të trajtuar në mënyrë të njëjtë situata objektivisht të njëjta ose të ngjashme, por edhe detyrimin për të trajtuar në mënyrë të ndryshme situata objektivisht të ndryshme dhe, në këto kushte, ata nuk mund dhe nuk duhet të trajtohen në mënyrë të barabartë me kategori të tjera që nuk ndodhen në të njëjtat kushte me ta.

Gjykata është shprehur në vendimet e saj të mëparshme se neni 18 i Kushtetutës “[...] *para së gjithash, sanksionon një detyrim negativ, sipas të cilit shteti duhet të mos ndërhyjë, me qëllim që askush të mos diskriminohet padrejtësisht [...]*” (Shih vendimin nr.33, datë 12.09.2007). Ky interpretim buron nga vetë natyra e parimit të barazisë përpara ligjit, të sanksionuar në nenin 18 të Kushtetutës, që nënkupton të drejtën për t’u trajtuar në mënyrë të barabartë, duke u mbrojtur nga diskriminime të pambështetura në një përligje të arsyeshme dhe objektive. Kërkuesit pretendojnë se parimi kushtetues i barazisë përpara ligjit duhet të interpretohet *in extenso*, duke përfshirë në kuptimin e tij detyrimin e shtetit për të ndërmarrë një rol aktiv në mënyrë që të garantohet trajtimi i ndryshëm i situatave të ndryshme. Gjykata vlerëson se Kushtetuta i imponon ligjvënësit mbrojtjen e barazisë dhe vetëm në raste përjashtimore lejon trajtime të diferencuara. Interpretimi i kërkuesve i jep një kuptim të gabuar parimit të barazisë përpara ligjit, të mbrojtur nga neni 18 i Kushtetutës siç është interpretuar nga kjo Gjykatë në jurisprudencën e saj të mëparshme.

Sa më sipër, Gjykata vlerëson se ky pretendim nuk është i mbështetur në ligj.

##### **5. Lidhur me pretendimin se ligji objekt gjykimi shkel parimin e sigurisë juridike**

Kërkuesit pretendojnë se ligji objekt gjykimi shkel parimin e sigurisë juridike, pasi cenon të drejtat e fituara nga ushtarakët e Forcave të Armatosura dhe nga punonjësit e Policisë së Shtetit nga zbatimi i ligjeve të mëparshme dhe të vendimeve të formës së prerë të gjykatave.

Gjykata rithekson se parimi i shtetit të së drejtës, i sanksionuar në nenin 4 të Kushtetutës, është një nga parimet më themelore e më të rëndësishme në shtetin dhe shoqërinë demokratike. Jurisprudenca e kësaj Gjykate referon te ky parim konceptin e sigurisë juridike, të së drejtës së fituar dhe të pritshmërive të ligjshme. Siguria juridike është një nga elementet më esenciale të parimit të shtetit të së drejtës dhe përfshin, krahas qartësisë, kuptueshmërisë dhe qëndrueshmërisë së sistemit normativ, edhe besimin te sistemit juridik, pa marrë përparësi garantimin e çdo pritshmërie për një situatë të favorshme ligjore. Në këtë pikëpamje duhet parë në çdo rast se në çfarë mase dhe deri ku besimi që ka qytetari në situatën e favorshme ligjore paraqitet i rëndësishëm për t’u mbrojtur dhe cilat janë arsyet për një mbrojtje të tillë. Ligjvënësi jo vetëm që ka të drejtë, por është i detyruar të rregullojë, nëpërmjet akteve të veta me hollësi të drejtat e parashikuara në Kushtetutë (Shih vendimet e Gjykatës Kushtetuese nr.10, datë 19.03.2008; nr.34, datë 20.12.2005; nr.26, datë 02.11.2005).

Siguria juridike presupozon, veç të tjerash, besueshmërinë e qytetarëve te shteti dhe pandryshueshmërinë e ligjit për marrëdhëniet e rregulluara. Besueshmëria ka të bëjë me bindjen e individit se nuk duhet të shqetësohet vazhdimisht ose të jetojë me frikë për ndryshueshmërinë dhe pasojat negative të akteve juridike, të cilat mund të cenojnë jetën e tij private ose profesionale dhe të përkeqësojnë një gjendje të vendosur me akte të mëparshme (Shih vendimet e Gjykatës Kushtetuese nr.24, datë 12.11.2008; nr.9, datë 26.02.2007).

Gjykata vëren se ligji objekt gjykimi unifikon kushtet dhe masën e përfitimeve suplementare të disa kategorive përfituesish. Gjykata vëren se ky unifikim ka sjellë pasoja pozitive për një kategori përfituesish dhe pasoja negative për një tjetër kategori, prandaj me të drejtë kërkuesit pretendojnë se disa prej dispozitave të ligjit objekt gjykimi cenojnë të drejtat e fituara për një pjesë të ushtarakëve të Forcave të Armatosura dhe të punonjësve të Policisë së Shtetit, duke ulur masën ose kohëzgjatjen e përfitimeve të tyre.

Gjykata vlerëson se, edhe pse kërkuesit pretendojnë shfuqizimin në tërësi të ligjit objekt gjykimi, në vështrimin e saj dispozitat që paraqesin probleme kushtetuese janë neni 14/2, neni 27 dhe neni 29/2 i këtij ligji. Neni 14/2 rregullon masën e pensionit të parakohshëm dhe parashikon se pensioni i parakohshëm për vjetërsi shërbimi kufizohet për personat që nuk kanë paguar kontribute suplementare në dyfishin e pensionit bazë të përcaktuar nga Këshilli i Ministrave, në përputhje me ligjin nr.7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", dhe për personat që kanë paguar kontribute suplementare, nuk mund të jetë më i madh se dyfishi i pensionit bazë të pleqërisë, plus 20 % të pagës referuese të muajit të fundit të punës.

Gjykata vëren se neni 27 i ligjit objekt gjykimi përjashton nga përfitimi, duke lenë jashtë rregullimit të këtij ligji ushtarakët që janë nxjerrë në lirim për shkak se janë dënuar me vendim gjyqësor, të formës së prerë me burgim, për krime të kryera me dashje, ndërkohë që neni 29/2 parashikon se pensionet e parakohshme për vjetërsi shërbimi dhe pensionet suplementare, të caktuara në përputhje me ligjet e mëparshme, si edhe ato të caktuara me vendime të gjykatave, pavarësisht nga mosha e vjetërsia

në punë, në çastin e fillimit të së drejtës, do të rillogariten sipas rregullave të përcaktuara në ligjin objekt gjykimi.

Pensioni i parakohshëm për vjetërsi shërbimi jepet në konsideratë të natyrës së punës të ushtarakëve ose punonjësve të Policisë së Shtetit, të cilët, pas ndërprerjes së karrierës, me ose pa dëshirën e tyre, e kanë të vështirë të gjejnë një vend pune të një niveli të krahasueshëm me funksionet që ushtronin. Ligjvënësi, duke marrë parasysh këtë konsideratë, parashikoi krijimin e një sistemi përfitimesh suplementare që të garantohet ruajtja e një niveli të krahasueshëm jetese dhe ekonomik për ushtarakët e Forcave të Armatosura dhe punonjësve të Policisë së Shtetit, të cilëve u ndërpriteshin marrëdhëniet e punës. Në këtë këndvështrim Gjykata vlerëson se pensioni i parakohshëm për vjetërsi shërbimi dhe pensioni suplementar i pleqërisë janë të drejta, të cilat mbrohen nga parimi i sigurisë juridike.

Gjykata vëren se dispozita e pikës 1 të nenit 14 të ligjit nr.10142, datë 15.5.2009 objekt gjykimi rregullon masën e përfitimit të pensionit të parakohshëm për vjetërsi shërbimi, ndërkohë që dispozita e pikës 2 të po këtij neni rregullon përlllogaritjen e masës së këtij pensioni në varësi të faktit nëse përfituesit e tij kanë paguar ose jo kontribute suplementare.

Gjykata thekson se siguria juridike nënkupton, veç të tjerash, edhe mbrojtjen e të drejtave të fituara të personave, të cilët kanë të drejtë të presin në mënyrë të arsyeshme që të drejtat e fituara, nëpërmjet akteve ligjore të vlefshme, t'u garantohen për të gjithë periudhën dhe të zbatohen realisht. Ligji duhet të ofrojë siguri dhe vijimësi me qëllim që individët të mund të kryejnë veprimet në mënyrën e duhur. Duke qenë se këto ligje e vendime perceptohen si burime pritshmërie të ligjshme për individët, ato nuk mund të ndryshohen e shfuqizohen në një fazë të mëvonshme. Ky parim u lejon individëve një lloj mbrojtjeje kundër ndryshimeve të menjëhershme e të pajustificueshme të rregullave. Gjykata ka theksuar, gjithashtu, edhe se parimi i sigurisë juridike nuk mund të prevalojë në çdo rast. Kjo do të thotë se, nëse paraqitet rasti që një rregullim ligjor ndryshe i një marrëdhënieje ndikohet drejtpërdrejt nga një interes i rëndësishëm publik, me të gjitha elementet e tij thelbësore, ky interes mund të ketë përparësi ndaj parimit të sigurisë juridike (*Shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 26, datë 02.11.2005*). Gjykata vëren se me rregullimin e ri të bërë nga pika 2 e nenit 14 vendoset një kufizim në masën e pensionit të parakohshëm për vjetërsi shërbimi, duke u vendosur një tavan maksimal. Gjykata vlerëson se vendosja e këtij kufizimi sjell si pasojë uljen e masës së pensionit të parakohshëm për një kategori përfituesish. Kjo ulje mund të jetë e përlligjor në funksion të uljes së shpenzimeve buxhetore dhe vështirësive paguese të shtetit, por subjektet e interesuara parashtruan se shpenzimet e Buxhetit të Shtetit për këto përfitime nuk pësojnë ulje nga zbatimi i ligjit objekt gjykimi. Këto subjekte nuk paraqiten përpara Gjykatës asnjë argument bindës që kjo ulje është bërë për arsye të një interesi publik. Nisur nga funksioni dhe rëndësia e pensionit të parakohshëm për vjetërsi shërbimi, zvogëlimi i masës së tij ose kufizimi nga neni 14/ 2 e ligjit objekt gjykimi të shumës maksimale që mund të përfitohet nuk janë veprime që mund të përlligjen me interesin e rëndësishëm publik. Për këtë arsye Gjykata çmon se dispozitat e nenit 14/2 të ligjit objekt gjykimi janë në kundërshtim me parimin e sigurisë juridike dhe të shtetit të së drejtës.

Përsa i përket rregullimit që sjell neni 27 i ligjit objekt gjykimi, pra përjashtimi nga përfitimet i ushtarakëve që janë nxjerrë në lirim për shkak se janë dënuar me vendim gjyqësor, të formës së prerë me burgim, për krime të kryera me dashje, Gjykata vlerëson se kjo dispozitë është një sanksion me natyrë pasurore dhe që për shkak të karakterit të saj strikt, barazohet me dënimin penal. Në nenin 34 të Kushtetutës parashikohet se : “*Askush nuk mund të dënohet më shumë se një herë për të njëjtën veprë penale ...*”. Kjo dispozitë kushtetuese sanksionon parimin “*non bis in idem*”: personi nuk mund të dënohet më shumë se një herë për të njëjtën shkelje të ligjit. Pikërisht ky përjashtim nga përfitimet suplementare të përfituesve, që janë dënuar nga gjykata për kryerjen e një krimi me dashje është i barabartë me një ridënim për të njëjtën veprë dhe për pasojë bie ndesh me dispozitën kushtetuese të lartpërmendur. Gjithashtu, Gjykata vëren se zbatimi i kësaj dispozite sjell pasoja negative edhe për ata ushtarakë, të cilët pas vuajtjes së dënimit me burgim janë rehabilituar.

Në lidhje me dispozitën e nenit 29 të ligjit objekt gjykimi, Gjykata vlerëson se mund të zbatohet një interpretim pajtues i kësaj dispozite. Ky interpretim është i mundur kur një ligj ose dispozitë ligjore mund të interpretohet në më shumë se një mënyrë, njëri nga të cilët është në pajtim me Kushtetutën. Kjo metodë kërkon efektet kushtetuese të rezultateve të ndryshme dhe përzgjedh rezultatin që është në pajtim me vlerat kushtetuese, duke marrë parasysh këtu të drejtat themelore të individëve (*Shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 29 datë 31.05.2010*).

Neni 29 i ligjit objekt gjykimi parashikon rilogaritjen e të drejtave të njohura në zbatim të ligjeve të mëparshme, pra parashikon se pensionet e parakohshme për vjetërsi shërbimi dhe pensionet suplementare të pleqërisë të caktuara në përputhje me këto ligje, si dhe ato të caktuara me vendime të gjykatave, pavarësisht nga mosha dhe vjetërsia në punë, në çastin e fillimit të së drejtës do të rilogariten, pra këto dispozita mund të prekin, duke ulur/pakësuar ose duke rritur të drejtat e fituara. Gjykata thekson se nuk mund të mohohen interesa dhe pritshmëri të ligjshme të qytetarëve nga ndryshimet në legjislacion dhe shteti duhet të synojë të ndryshojë një situatë të rregulluar më parë vetëm nëse ndryshimi sjell pasoja pozitive, konkretisht trajtim më të mirë financiar për subjektet përfituese.

Gjykata ka theksuar, në jurisprudencën e saj, se rregullimet ligjore që kanë të bëjnë me të drejtat e shtetasve duhet të kenë qëndrueshmëri të mjaftueshme që siguron vijimësinë e tyre. Sanksionimi i të drejtave dhe lirive të njeriut të pranuar në Kushtetutë dhe shoqërimi i tyre me masat për vënien në jetë të tyre duhet të synojë përmirësimin dhe rritjen e standardeve të të drejtave, forcimin e shtetit të së drejtës (*Shih vendimet e Gjykatës Kushtetuese nr.9, datë 26.02.2007; nr.34, datë 20.12.2005*). Parimi i shtetit të së drejtës përmban në vetvete edhe detyrimin e autoriteteve publike për të vënë në ekzekutim vendimet gjyqësore të formës së prerë. Siguria juridike nënkupton që, në rastet kur gjykatat kanë vendosur përfundimisht për një çështje, vendimet e tyre nuk duhet të vihen në dyshim (*Shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 24, datë 12.11.2008*). Asnjë organ shtetëror nuk mund të vërë në diskutim drejtësinë e vendimeve gjyqësore të formës së prerë dhe askujt nuk i lejohet të vërë në diskutim njohjen dhe vlerën e vendimeve apo të refuzojë zbatimin e tyre, pasi ato kanë marrë formë të prerë (*shih vendimet e Gjykatës Kushtetuese nr.20, datë 9.07.2009; nr.9, datë 1.05.2009, nr.6, datë 6.03.2009; nr.1, datë 19.01.2009; nr.6, datë 31.03.2006; nr.11, datë 27.05.2004*).

Në konsideratë të këtyre përcaktimeve, Gjykata vlerëson se qëllimi i dispozitave të neni 29 të ligjit objekt gjykimi, duke u nisur nga konteksti i saj, si dhe konteksti i përgjithshëm i këtij ligji, është që kjo rilogaritje e këtyre të drejtave të fituara në zbatim të ligjeve të mëparshme ose dhe të vendimeve të gjykatave, do të bëhet vetëm në rast se ndryshon pozitivisht, pra përmirëson situatën e përfituesve. Në asnjë rast nuk lejohet që të kryhet një rilogaritje që do të çonte në përkeqësimin e situatës pozitive ose në cenimin e të drejtave të fituara. Në rast të kundërt, pra nëse do të bëhej një interpretim dhe zbatim ndryshe i kësaj dispozite, atëherë do të ishim përpara cenimit të parimit të sigurisë juridike. Nga subjektet e interesuara nuk u dhanë argumente për të justifikuar cenimin e sigurisë juridike për një interes të rëndësishëm publik. Qëllimin e mbrojtjes së sigurisë juridike e ka pasur parasysh dhe ligjvënësi, duke parashikuar në nenin 24 paragrafi i parë të ligjit objekt gjykimi se përfitimet suplementare, pasi janë llogaritur, nuk janë më objekt të ndonjë ndryshimi me përjashtim të indeksimit të bërë me vendim të Këshillit të Ministrave.

Gjykata, bazuar në këtë interpretim pajtues, arrin në përfundimin se neni 29 i ligjit 10142, datë 15.05.2009 është i pajtueshëm me Kushtetutën, me kusht që dispozitat e tij të interpretohen si më sipër. Asnjë interpretim tjetër i këtyre dispozitave nuk është i lejueshëm nga pikëpamja kushtetuese dhe se mbrojtja e të drejtave të fituara nuk mund të arrihet në rast se dispozitave të kundërshtuara u jepet një kuptim tjetër. Duke u nisur nga interpretimi i mësipërm, Gjykata Kushtetuese arrin në përfundimin se kjo dispozitë nuk cenon parimin e sigurisë juridike.

Sa më sipër, Gjykata vlerëson se neni 14/2 dhe neni 27 i ligjit nr.10142, datë 15.05.2009 "Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura, të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit Informativ të Shtetit, të Policisë së Burgjeve, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit e të punonjësve të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm në Republikën e Shqipërisë" janë të papajtueshme me Kushtetutën, sepse cenojnë parimin e sigurisë juridike dhe si të tilla ato duhen shfuqizuar.

#### PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, duke u bazuar në nenet 131, shkronja "f" dhe "g", neni 134, pika 1, shkronja "ë" të Kushtetutës, si dhe në nenet 72 e 77 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", me shumicë votash,



## VENDOSI:

- Shfuqizimin si antikushtetues të pikës 2 të nenit 14, si dhe të nenit 27 të ligjit nr.10142, datë 15.05.2009 “Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura, të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit Informativ të Shtetit, të Policisë së Burgjeve, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit e të punonjësve të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm në Republikën e Shqipërisë”.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë pro: Kujtim Puto, Petrit Ploçi, Sokol Berberi, Sokol Sadushi  
Anëtarë pjesërisht kundër: Fehmi Abdiu, Vitore Tusha<sup>3</sup>, Admir Thanza<sup>4</sup>  
Anëtarë kundër: Vladimir Kristo (kryetar), Xhezair Zaganjori

---

<sup>3</sup> Gjyqtarja Vitore Tusha është kundër vendimit të shumicës për shfuqizimin e pikës 2 të nenit 14 të ligjit nr.10142, datë 15.05.2009.

<sup>4</sup> Gjyqtari Admir Thanza është kundër vendimit të shumicës për shfuqizimin e pikës 2 të nenit 14 të ligjit nr.10142, datë 15.05.2009 dhe interpretimit për mbrojtjen e pensionit suplementar të pleqërisë nga parimi i sigurisë juridike, kur nuk është derdhur kontributi përkatës.

**Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi "Gjergj Fishta", mbrapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", tel: 04 24 27 003.**

Çmimi i abonimit në postë për Fletoret Zyrtare 2010 është 16 000 lekë.

Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

### BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

KODI PENAL .....	226 lekë
KODI I PROCEDURËS PENALE.....	330 lekë
KUSHTETUTA .....	95 lekë
PËRMBLEDHJE PËR KTHIMIN DHE KOMPENSIMIN E PRONAVE	140 lekë

Hyri në shtyp më 21.7.2010

Doli nga shtypi më 22.7.2010

Tirazhi: 2300 copë	Formati: 61x86/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare  
Tiranë, 2010

Çmimi 28 lekë